



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Administrim dhe Politikë Sociale”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Enis FITA

Dr. Teuta NUNAJ

Shtator / 2025


**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “ADMINISTRIM DHE POLITIKË SOCIALE”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Administrim dhe Politikë Sociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 976, datë 08.10.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 196, datë 19.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademikë / 6 semesta
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a. 2022-2023, 19 PAE / 18 PAK; V.a. 2023-2024, 19 PAE / 17 PAK; V.a. 2024-2025, 19 PAE / 19 PAK.
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023, 96 studentë të regjistruar; V.a 2023-2024, 71 studentë të regjistruar; V.a 2024-2025, 73 studentë të regjistruar.
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) ushtron aktivitetin e edukimit në fushën e arsimit të lartë. Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 348, datë 10.08.1992 në strukturën e tij u përfshi edhe Fakulteti i Shkencave Sociale (FShS). UT ka kryer tre akreditime institucionale dhe me vendim nr. 4 të Bordit të Akreditimit, dt. 27 janar 2023, institucioni është i akredituar deri më dt. 26.01.2029.

Fakulteti i Shkencave Sociale ka në strukturën e tij 5 (pesë) departamente:

1. Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë;
2. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale;
3. Departamenti i Filozofisë;
4. Departamenti i Sociologjisë;
5. Departamenti i Shkenca Politike;

Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale (DPPS) ofron 10 programe studimi: dy programe janë në ciklin e parë Bachelor (BA); dy programe janë në ciklin e dytë Master Profesional; pesë programe janë në ciklin e dytë Master i Shkencave; dhe një program është në ciklin e tretë në Doktoraturë.

DPPS ofron programin e studimit Administrim dhe Politikë Sociale (APS), APA ui hapur me VKM nr. 976, dt. 08.10.2009, me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me 180 kredite dhe me kohëzgjatje maksimale 3 vite akademike ose 6 semestra. Në përfundim të programit lëshohet "Diplomë" ose "Specialist i padiplomuar" nëse studenti nuk fiton mbrojtjen e diplomës sipas kriterëve të UT-së. Përmes këtij raporti të vlerësimit të jashtëm (RVJ) analizohet ecuria e programit të studimit, i cili akreditohet për herë të parë.

Programi APS ka për qëllim të përgatisë profesionistë të aftë për të adresuar nevojat sociale në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ky program është ndërtuar që t'i mundësojë studentit zhvillimin e aftësive profesionale, etike dhe analitike në fushën e administrimit dhe të politikave sociale. Në qendër të programit APS janë lëndë të karakterit social, ekonomik e kërkimi metodologjik, të cilat përfshihen me profilet dhe fushat e studimit të stafit akademik të DPPS. Rishikimi i syllabuseve realizohet në mënyrë të përvitshme nga titullarët e lëndëve, ndërsa ndryshimet e planit mësimor të programit janë bërë me vonesë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Për vlerësimin e programit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale ofruar nga FShS të UT-së, ASCAL, mbështetur mbi aktet ligjore, nënligjore e rregullative të funksionimit të institucionit, ka kryer procesin përgjeshës të ekspertëve të jashtëm, të cilët kanë për detyrë të (i) analizojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përcjellë nga DPPS; (ii) të zhvillojnë vizitën në institucion, të kryejnë takime me drejtues e anëtarë të stafit akademik sipas agjendës së përcaktuar dhe të kontrollojnë fizikisht dokumentacionin e ambientet që përdoren për procesin mësimdhënës e atë ndihmës; si dhe (iii) të hartojë raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga: **Dr Enis Fita** dhe **Dr. Teuta Nunaj**, i cili u asistua përgjatë të gjithë procesit nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Muhamed Prezja.

Për vlerësimin e programit APS, ofruar nga FShS puna filloi me marrjen dijeni të agjendës së miratuar të takimeve në institucion, me njohjen e plotë të dokumentacionit të përgatitur nga DPPS dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), me ndarjen e punës mes anëtarëve të GVJ, me ndërtimin e strukturës së pyetjeve për secilin grup takimi që do të zhvillohej në institucion dhe me përgatitjen e listës për dokumentat shtesë që do t' kërkohejshin GVB. Në FShS takimet u zhvilluan në mbështetje dhe në respekt të plotë të agjendës. GVJ kreu takime me: Dekanin e FShS, Përgjegjësin e departamentit PPS që ofron programin e studimit APS, me GVB, me stafin akademik që jep mësim në programin APS, me studentë në programin APS, me sekretarinë mësimore të FShS, me drejtues e anëtarë të zyrave mbështetëse si: Zyra e Burimeve Njerëzore, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës, Alumnit dhe Marrëdhënieve me studentët, Zyra e Kualifikimit Shkencor dhe Projekteve e Punonjësit e Bibliotekës. Përgjatë takimeve, GVJ parashtrroi pyetjet përkatëse dhe kërkesat për dokumentacion shtesë.

Njëkohësisht, GVJ zhvilloi një kontroll fizik të detajuar të aditorëve ku zhvillohet mësimi dhe të bibliotekës. GVJ shqyrtoi dokumentacionin fizik të ofruar nga FShS, por edhe të kërkuar nga vetë GVJ si: Dosja e personelit të brendshëm dhe të jashtëm (CV, diploma, listë notash, kualifikime); Kontrata me stafin e programit me kohë të plotë e të pjesshme; Regjistrin e regjistrimit të studentëve (gjatë pranimit); Rregjistrat themeltar dhe të diplomave, regjistrin e arritjeve akademike; regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, dosje studenti; Procesverbalet e provimeve të lëndëve në programin APS; si dhe rregjistrat e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm. Nga GVJ u përcollë kërkesë për disa dokumenta që mungonin si: vendimi për krijimin e GVB, përditësimi i tabelave me të dhënat e azhurnuara për vitin akademik 2025-2026, me rugën e ndjekur për përmirësimin e planit mësimor, një strukturë teze provimi, numri studentëve të regjistruar, transferuar, etj. Me përmbylljen e takimeve në FShS, puna e GVJ vijoi me hartimin e RVJ, mbështetur në dokumentacionin, përfshirë edhe atë shtesë të përcjellë nga DPPS në sistemin e ASCAL dhe mbi informacionin e siguruar gjatë takimeve të realizuara në institucion. Në përfundim, GVJ dorëzon draft-raportin e vlerësimit të jashtëm për programin APS ofruar nga FShS.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.06.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 22/22 Prot, datë 16.06.2025. Universiteti i Tiranës ", nuk ka përcjellë komente mbi draft raportin, në këtë mënyrë draft raporti ktheht në raport final.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim dhe Politikë Sociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës është i pari institucion i themeluar në arsimin e lartë në Shqipëri, është universitet publik dhe me një gamë të plotë të programeve në të gjitha ciklet e studimit të parashikuara nga legjislacioni shqiptar. UT ka një mision të qartë dhe kontribon në zhvillimin e shoqërisë dhe ofrimin e edukimit të studentëve për karrierë produktive dhe qytetare. Institucioni ka ndërtuar strategji të qarta në të gjitha nivelet e tij dhe që ndërlidhen me njëra-tjetrën, në të cilat theksohet si objektivi themelor lidhja e programeve të studimit me tregun e punës dhe përfshirjen e komunitetit të biznesit në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të studimit. Këtë objektivi e gjejmë të shtrirë vertikalisht nga lart-poshtë. Programi i studimit Administrim dhe Politikë Sociale (APS) ka për mision përgatitjen e profesionistëve të aftë për të adresuar nevojat dhe sfidat sociale në Shqipëri përmes administrimit efektiv të burimeve dhe politikave, duke promovuar drejtësinë sociale dhe ekonomike. Ndaj, programi i studimit APS shërben si një mbështetës i konsolidimit të vlerave akademike dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. <i>(Statusi i Universitetit të Tiranës; Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028; Evidenca 2.3, Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 3.2, Plani Strategjik 2021-2024 i Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.5, Strategji e Zhvillimit të Programit Bachelor “Administrim dhe Politikë Sociale” 2021-2025)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Ka një harmoni mes misionit e objektivave të shprehur në strategjinë e institucionit dhe misionit e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të Programit Bachelor “Administrim dhe Politikë Sociale” 2021-2025, ku në qendër është përgatitja e studentëve cilësorë për tregun e punës. Programi i studimit

institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	APS është në përputhje me fushën e veprimtarisë së FShS dhe të UT-së në tërësi. <i>(Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028; Evidenca 2.3, Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 3.5, Strategji e Zhvillimit të Programit Bachelor "Administrim dhe Politikë Sociale" 2021-2025)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Dokumentat strategjik të hartar nga IAL-ja janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në mënyrë harmonike. Programi i studimit APS ofrohet në zbatim të strategjisë dhe rregullores së FShS, të strategjisë së Departamentit të PPS dhe të vetë strategjisë së programit, duke krijuar një përputhje harmonike zbatueshmërie të tyre. Programi i studimit APS është në të njëjtën fushë drejtimi akademik me FShS që e ofron atë. <i>(Statusi i Universitetit të Tiranës; Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028; Evidenca 2.3, Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 2.4, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale; Evidenca 3.2, Plani Strategjik 2021-2024 i Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.5, Strategji e Zhvillimit të Programit Bachelor "Administrim dhe Politikë Sociale" 2021-2025)</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit APS ofrohet nga DPPS që prej vitit akademik 2009-2010. Në vitin akademik 2024-2025 në përbërjen e departamentit kemi 21 Personel Akademik efektiv (PAE): 1 Prof. Dr., 13 Prof. Assoc. Dr., 5 Dr., 2 anëtarë Msc janë në proces doktoreture dhe 1 anëtarë si personel ndihmës akademik. Ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë angazhuar 68 prej tyre dhe përbëhen nga 3 Prof. As., 19 Dr., dhe 46 Msc. Të angazhuar në programin e studimit APS për v.a. 2024-2025 kemi 19 PAE, 1 Prof. Dr., 12 Prof. As., 5 Dr. dhe 1 Msc, ndërsa PAK janë angazhuar 19 prej tyre dhe përbëhen nga 1 Prof. As., 3 Dr. dhe 15 Msc. Një mbështetje për plotësimin e nevojave të departamentit janë edhe stafi i jashtëm, prej të cilëve kishte edhe ish-studentë të FShS. Stafi i programit vijon prej vitesh të jetë pjesë e këtij fakulteti dhe me kontribute të vazhdueshme dhe shumë domethënëse në shoqëri. Veçojmë angazhimin e tyre për ngritjen e Urdhërit të Punonjësve Socialë dhe zhvillimin e këtij

	sektori profesional në vend. Pesë anëtarë të DPPS janë pjesë e Këshillit Kombëtar të këtij Urdhëri. Angazhimi akademik i qëndrueshëm dhe ai profesional për shoqërinë që ofrojnë anëtarët e DPPS mundësojnë që institucioni të ofrojë burimet e duhura njerëzore në fushë specifike akademike. Aktualisht, FShS është në proces ndërtimi të laboratorëve, që do të mundësojë në të ardhmen edhe infrastrukturën e duhur për zhvillimin e programeve të tij. <i>(Evidenca 2 shtesë, VKM nr. 976, dt. 08.10.2009 "Për hapjen e programit të ciklit të parë Administrim dhe Politikë Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale..."; Evidenca 3 shtesa, Tabla Përmbledhëse e RVB-së; Evidenca 4 shtesë, Kontribut i stafit për Urdhërin e Punonjësit Social; Evidenca 33 shtesë, Shkresa dhe buxheti për pajisjen me laboratorë TIK)</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit APS është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore FShS dhe të njësisë bazë DPPS, që është edhe njësia përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi. Në mbështetje të Vendimeve e Udhëzimeve të MAS për klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas kriterëve kombëtare dhe europiane, FShS në shkresën e datës 31 mars 2023 ka paraqitur pranë Rektoratit propozimet përkatëse për kodifikimin e programeve të studimit. Gjatë takimit në institucion me Dekanin dhe Përgjegjësën e DPPS për vijimin e procesit të kodifikimit na u shpjegua se Rektorati ka përcjellë propozimet në MAS dhe janë në pritje të përgjigjes së tyre. <i>(Evidenca 8 shtesë, Shkresa dhe kontributi i institucionit për kodifikimin)</i>			
Konkluzione	<i>FShS dhe DPPS ofrojnë programin e studimit APS në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e tyre, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë. Institucioni ka të gjitha kapacitetet dhe burimet njerëzore në fushën akademike për zhvillimin e plotë të këtij programi. Ndërtimi i laboratorëve si kapacitete të reja infrastrukturore do të jetë një vlerë e shtuar për ofrimin e programit APS nga ana e institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni ka të ngritur strukturën rregullative për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e të gjithë aktivitetit të tij akademik e administrative të tij. Hartimi i planeve strategjike e akteve të brendshme rregullative nga lart-poshtë dhe që përfshin të gjitha hallkat hierarkike e funksionale të njësive kryesore, ofron mundësi për marrëdhënie bashkëpunuese mes të gjitha strukturat pjesë të FShS, njëkohësisht tregon për kujdesin nga institucioni për organizimin dhe ndarjen e punës, si mes njësive/zyrave/struktura ve edhe mes stafit akademik e administrativ. Statuti dhe Rregullorja e UT-së, si dhe aktet e tjera të brendshme institucionale rregullojnë tërësinë e veprimtarisë të FShS dhe të DPPS në veçanti. Departamenti përmes strukturave të tij kontrollon në mënyrë të vazhdueshme realizimin e programit dhe të detyrave nga anëtarët e tij. Përgjatë takimit me stafin akademik e ndihmës akademik të departamentit, pyetjeve të GVJ për funksionin e proceseve analizuese e vendimmarrëse në departament, ato u shprehën se zhvillojnë rregullisht mbledhje në departament në prani të anëtarëve të tij dhe sekretares që mban procesverbalin, analizojnë çështjet e përcaktuara në agjendën e mbledhjes dhe marrin vendim me shumicë të thjeshtë e votim të hapur. Ndërkohë që stafi i departamentit ka marrë paraprakisht dijeni 48 orë më parë për agjendën e mbledhjes. <i>(Statusi i Universitetit të Tiranës; Rregullore e Universitetit të Tiranës, Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.3, Rregullore e DPPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe	Si në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, bashkëpunimi me institucione e organizata brenda e jashtë vendit mbeten objektiva themelore të institucionit. Në Strategjinë e FShS promovimi i bashkëpunimit me sektorin privat e publik mbeten themelore për lehtësimin dhe transferimin e njohurive në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në Startegjinë e DPPS shohim se drejtimi i dytë strategjik lidhet me angazhimin e departamentit me institucionet për advokim, kërkim dhe mbështetje me ekspertizë teknike. Ndaj edhe DPPS ka lidhur partneritete dhe bashkëpunon me organizata që punojnë në komunitete të ndryshme. Në aspektin faktik, institucioni ka bashkëpunime konkrete me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, gjë që ka mundësuar për stafin akademik procese shkëmbime të vazhdueshme përmes programeve e projekteve si psh. Erasmus, Gradua, zhvillimin e simpoziumeve, tryezave rrumbullake, konferencave të përbashkëta ndërkombëtare, si psh. Konferenca e gjashtë Ndërkombëtare Shkencore, me temë “Arrijtjet dhe sfidat e profesionit të punës sociale”, më 24.05.2024, si dhe angazhimin profesional të stafit akademik në sektorin e çështjeve sociale në vend përmes kontributit për ngritjen e Urdhërit të Punonjësit Social, etj. Për studentët, këto bashkëpunime kanë mundësuar realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi punësimi për të diplomuari. <i>Nga të dhënat e përcjella shihet se studentët e programit të studimit APS nuk ka patur mobilitete Erasmus. Njëkohësisht GVJ vlerëson angazhim të ulët të stafit akademik në programin Erasmus e programe të tjera ndërkombëtare, në të cilat kanë marrë pjesë vetëm 9 anëtarë nga 21 anëtarë që ka DPPS.</i> GVJ rekomandon për rritjen e bashkëpunimit dhe përfshirjen e stafit të studentëve në programet ndërkombëtare, kryesisht Erasmus+. <i>(Evidenca 2.3, Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 3.2, Plan i Strategjik 2021-2024 i Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 2.24, Tabelë me aktivitete, Lista e aktiviteteve; Evidenca 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5 shtesë, Aktivitete me natyrë kërkimore 2019-2024; Evidenca 11 shtesë, Marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerët për praktikën e studentëve; Evidenca 13 shtesë, Lista e angazhimit të stafit dhe studentëve në programet mobility Erasmus; Evidenca shtesë, Informacion sqarues për dokumentacionin plotësues për BA në APS)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme	Në planin mësimor të programit të studimit APS është përfshirë me 3 kredite “Praktikë aktive në institucione” dhe po me 3 kredite “Praktikum” që studentët do të duhet të zhvillojnë. Dokumentat si Manuali i praktikës profesionale për programin

me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	e studimit APS dhe Modeli i dosjes së praktikës profesionale përcaktojnë detyrat e palëve bashkëpunuese për realizimin me sukses të praktikës nga ana e studentëve dhe njëkohësisht modalitetet e nevojshme për kryerjen e praktikës profesionale nga student dhe vlerësimin e saj nga departamenti. Në dokumentin “Marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerët për praktikën e studentëve” janë të renditur marrëveshjet që FShS ka nënshkruar me institucionet partnere për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. <i>(Evidenca 3.17, Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve për praktikat profesionale; Evidenca 4.2a, Plani mësimor i programit të studimit APS; Evidenca 4.4, Dokumentat e praktikës: Manuali i praktikës profesionale; Evidenca 11 shtesë, Marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerët për praktikën e studentëve; Evidenca 12 shtesë, Modeli i dosjes së praktikës profesionale)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DPPS është i angazhuar në përgatitjen e vazhdueshme dhe periodike të raporteve: (i) për aktivitetin e tij; (ii) për angazhimin e stafit të akademik; (iii) për rezultatet e bashkëpunimit me partnerët mbi bazën e marrëveshjeve bilaterale, të cilat ndihmojnë në realizimin e programit të studimit APS. DPPS është përgjegjës për ndjekjen e praktikave mësimore që kryejnë studentët në institucione/organizata/biznese dhe përgatit rregullisht raportet analitike për përfitimet nga marrëveshjet me partnerët. <i>(Evidenca 3.18, Raporti i veprimtarisë së DPPS 2021-2024; Evidenca 3.19, Raporti i fundit periodik analitik i përfitimit nga marrëveshjet; Evidenca 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5 shtesë, Aktivitete me natyrë kërkimore 2019-2024; Evidenca 18.1, 18.2, 18.3, Raporti vjetor i DPPS 2021-2024)</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me organizata partnere apo kompani biznesi në funksion të realizimit të programit të studimit APS dhe në kuadër të kërkimit shkencor e mobilitetit të stafit të DPPS, pasi studentët nuk kanë patur mobilitet. Po kështu, DPPS ka marrëveshje bashkëpunimi me partner për zhvillimin e praktikave profesionale specifiku të studentëve të programit APS, të cilat kanë për qëllim aftësimin profesional të studentëve për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Plani mësimor që aktualisht po zbatohet në programin APS është prej vitit akademik 2018-2019 dhe ai është i organizuar në 3 (tre) vite akademike dhe 6 (gjashtë) semestra, ku pasqyrohen tipologjia e veprimtarisë, lëndët e vlerësuar në kredite (ECTS), orët në auditor e studim individual, ngarkesa dhe viti e semestri kur realizohen. Por, kërkesat për ndryshime në planet mësimore të shprehura në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 sipas RVB e sipas dokumentit “Informacion sqarues për dokumentacionin plotësues për Ba në APS” janë bërë vetëm në vitin 2024 dhe janë planifikuar të zbatoheni brenda vitit akademik 2025-2026. Pavarësisht kohës dhe procedurave të ndjekura, <i>GVJ vlerëson se DPPS është shumë i vonuar me fillimin e punës për pasqyrimin e ndryshimeve të kërkuara nga VKM e sipërcituara dhe me zbatimin e tyre.</i> <i>Mos respektimi ende i kërkesave ligjore është i pajustificuar dhe mbetet një mangësi themelore për departamentin e PPS që ka përgjegjësinë për zhvillimin e programit APS.</i> (Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.2b. Ndryshimet në planet mësimore, 2023-2024; Evidenca 7.1 shtesë, Plani mësimor i ndjekur 5 vite me parë; Evidenca 7.2 shtesë, Plani i ri mësimor me ndryshimet që janë bërë (A-E) Procedura dhe Plani mësimor; Evidenca

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>shtesë, Informacion sqarues për dokumentacionin plotësues për BA në APS)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit APS ka për mision të përgatisë profesionistë të aftë për të adresuar nevojat dhe sfidat sociale përmes administrimit efektiv të burimeve dhe politikave, duke promovuar drejtësinë sociale dhe ekonomike. Programi synon të ofrojë një edukim gjithëpërfshirës dhe ndërdisiplinor duke integruar teorinë dhe praktikën për zhvillimin e aftësive analitike, etike dhe krijuese, që ndihmojnë në përmirësimin e mirëqënies sociale në nivel kombëtar. Ndër objektivat kryesore të programit të studimit APS janë: (i) fuqizimi profesional i studentëve; (ii) njohuri mbi politikët dhe programet sociale; (iii) promovimi i drejtësisë dhe barazisë sociale; (iv) planifikimi dhe vlerësimi i shërbimeve sociale; dhe (v) zhvillimi i vazhdueshëm profesional gjatë të gjithë jetës. Organizimi i pyetësorëve që ju adresohen studentëve ndihmon në identifikimin e kërkesave të tyre dhe nevojën për përmirësim, që studentët rekomandojnë. Në takim me stafin e programit dhe me anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) u shpjegua se pyetësi hartohet nga NjSBC dhe përmirësohet vit pas viti. Zyra e IT e përcjellë elektronikisht tek studentët, të cilët e plotësojnë online. Raporti për të dhënat e këtyre pyetësorëve hartohet nga NjSBC dhe më tej ju përcillen departamenteve. Kur ka ankesë nga studentët, trajtesa bëhet nga përgjegjësi i departamentit me pedagogun që cilësohet në departament. <i>GVJ rekomandon që departamentet të shprehen në mënyrë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha ankimimet apo kërkesat e shprehur nga studentët, gjithnjë pasi janë diskutuar në mbledhjen e departamentit dhe të evidentohen zgjidhjet e mundshme që ju janë dhënë kërkesave të studentëve.</i> <i>(Evidenca 3.5, Strategji e Zhvillimit të Programit Bachelor "Administrim dhe Politikë Sociale" 2021-2025; Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022-2023; Evidenca 4.18b, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024)</i>

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Programi i studimit APS ka të përcatuar në planin e tij mësimor ngarkesën e moduleve në kredite (ECTS) të ndara sipas veprimtaris formuese dhe me ngarkesën përkatëse të krediteve.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, VKM 185, dt. 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, dt. 24.01.2018 'Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë', të ndryshuar", elementët e programeve të studimit të pasqyruara në planin mësimor që zbatohet në vitin akademik 2024-2025 nuk janë të njëjtë me ato që kërkohen nga aktet nënligjore, pasi kemi 6 komponentë mësimor më kategorinë e lëndëve dhe 1 për detyrimet përmbyllëse nga 5 kategori të lëndëve dhe 1 për detyrimet përmbyllëse që kërkohen nga aktet nënligjore.

Raporti i lëndëve sipas veprimtarive formuese janë:

- Lëndët (A), 35 kredite → 19.4% kredite;
- Lëndët (B), 82 kredite → 45.5 % kredite;
- Lëndët (C), 28 kredite → 16.5 % kredite;
- Lëndët (D), 12 kredite → 6.6% kredite;
- Lëndët (E), 18 kredite → 10% kredite;
- Lëndët (F), 5 kredite → 2.8% kredite.

Ndërkohë, në planin mësimor të miratuar që do të fillojë zbatimin në vitin akademik 2025-2026, edhe pse nuk është objekt vlerësimi në këtë raport, GVJ shpreh se në bazë të akteve nënligjore të sipërcituara kemi kategoritë:

- Lënda bazë (A), 15% - 20% kredite → 19.4% kredite;
- Lënda karakterizuese (B), 50% - 55% kredite → 53.3 % kredite;
- Lënda ndërdisiplinore/integruese (C), 12% - 15% kredite → 14.4 % kredite;
- Lëndë plotësuese (D), 10% - 15% kredite → 10% kredite;
- Detyrime përmbyllëse (E), 3% - 5% kredite → 2.8% kredite.

Nga të dhënat shihet se detyrimet përmbyllëse nuk janë plotësisht në përputhje me kriteret e përqindjeve të përcaktuara në aktet nënligjore.

GVJ vlerëson se fillimi i punës nga departamenti për ndryshimet e planit mësimor sipas kritereve ligjore është shumë e vonuar dhe mbetet e papërligjur mos zbatimi ende i kritereve ligjore.

	(VKM 185, dt. 25.03.2021 të ndryshuar, Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.2b. Ndryshimet në planet mësimore, 2023-2024; Evidenca 7.1 shtesë, Plani mësimor i ndjekur 5 vite me parë; Evidenca 7.2 shtesë, Plani i ri mësimor me ndryshimet që janë bërë (A-E)_Procedura dhe Plani mësimor; Evidenca shtesë, Informacion sqarues për dokumentacionin plotësues për BA në APS)
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Plani mësimor i programit të studimit APS që është në zbatim ka të përcaktuar kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse, të cilat siç e analizuam e shprehëm më lart nuk janë në përputhje me atet nënligjore në fuqi dhe kemi si më poshtë: • Praktika profesionale → 6 kredite; • Detyrime përmbyllëse → 5 kredite. Ndërkohë, në planin e miratuar që do të fillojë zbatimin në vitin akademik 2025-2026, edhe pse nuk është objekt vlerësimi në këtë raport, GVJ shpreh se kemi: • Lëndë plotësuese (D), 10% - 15% kredite → 10% kredite; • Detyrime përmbyllëse (E), 3% - 5% kredite → 2.8% kredite GVJ vlerëson se plani mësimor që është në zbatim nuk është në përputhje me kritret e përcaktuara nga aktet nënligjore, VKM 185, dt. 25.03.2021 i ndryshuar dhe plani i ri i miratuar që do të fillojë zbatimin në vitin akademik 2025-2026 ka një mospërputhje në përqindje për kategorinë përmbyllëse, pjesa tjetër është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. (VKM 185, dt. 25.03.2021 të ndryshuar, Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.2b. Ndryshimet në planet mësimore, 2023-2024; Evidenca 7.1 shtesë, Plani mësimor i ndjekur 5 vite me parë; Evidenca 7.2 shtesë, Plani i ri mësimor me ndryshimet që janë bërë (A-E)_Procedura dhe Plani mësimor; Evidenca shtesë, Informacion sqarues për dokumentacionin plotësues për BA në APS)
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe	N / A




financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.																									
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Ba në APS që ofrohet nga UT ka të njëjtën fushë studimit, cikël dhe emërtim me programin “Administrim dhe Politikë Sociale” ofruar nga Universiteti “Fan Noli” Korçë (UFNK). Nga krahasimi i planeve mësimore shohim se: <table><tr><th colspan="2">Programi APS ofruar nga UT</th><th colspan="2">Programi APS ofruar nga UFNK</th></tr><tr><th>Vitet</th><th>Nr. lëndëve¹</th><th>Vitet</th><th>Nr. lëndëve</th></tr><tr><td>I parë</td><td>13</td><td>I parë</td><td>12</td></tr><tr><td>I dytë</td><td>12</td><td>I dytë</td><td>11</td></tr><tr><td>I tretë</td><td>11</td><td>I tretë</td><td>9</td></tr><tr><td>Totali</td><td>36</td><td>Totali</td><td>32</td></tr></table> Gjithsej janë 16 lëndë me të njëjtin përmbajtje dhe 7 prej tyre me fushë studimit të njëjtë. Në total janë 23 lëndë me përmbajtje të njëjtë ($23/32 = 72\%$) në të dy programet e studimit ofruar nga UT dhe UFNK. Numri i lëndëve me zgjedhje për të dy universitetet nuk është llogaritur mbi totalin e lëndëve të ofruara, por sa prej tyre mund të zgjidhen për relizimin e planit mësimor. <i>(Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 7.1, Plani mësimor i ndjekur 5 vite më parë; Evidenca 4.2c, Programi i studimit Administrim dhe Politikë Sociale, Universiteti Fan Noli Korçë)</i>	Programi APS ofruar nga UT		Programi APS ofruar nga UFNK		Vitet	Nr. lëndëve ¹	Vitet	Nr. lëndëve	I parë	13	I parë	12	I dytë	12	I dytë	11	I tretë	11	I tretë	9	Totali	36	Totali	32
Programi APS ofruar nga UT		Programi APS ofruar nga UFNK																							
Vitet	Nr. lëndëve ¹	Vitet	Nr. lëndëve																						
I parë	13	I parë	12																						
I dytë	12	I dytë	11																						
I tretë	11	I tretë	9																						
Totali	36	Totali	32																						
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe	Në mbështetje dhe respektim të akteve nënligjore për kodifikimin e programeve, FShS ka kryer propozimet përkatëse, ka dërguar shkresën në Rektorat dhe më tej është																								




klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	përcjellë për në MAS dhe priten përgjigja prej këtij insitucioni për të vijuar më pas me kodifikimin e lëndëve. (Evidenca 8 shtesë, Shkresa dhe kontributi i institucionit për kodifikimin)			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A			
Konkluzione	Njësia bazë në bashkëpunim me njësinë kryesore kanë punuar për hartimin dhe organizimin e planit mësimor mbështetur në aktet ligjore në fuqi. GVJ e vlerëson si të pajustificuar dhe të papërligjur vonesën e fillimit të punës për ndryshimet e planit mësimor sipas kërkesave ligjore dhe më tej moszbatimin ende të planit të ri mësimor me ndryshimet e kërkuara fillimisht nga VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe më pas nga VKM nr. 185, dt. 25.03.2021. Nga ana tjetër, programi ka të përcaktuar qartë ndarjen e lëndëve në vite akademike e semestra, ka të përcaktuar kategoritë, kreditet dhe ndarjen e orëve për secilën lëndë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike,	FShS është i organizuar në 5 (pesë) departamente: 1. Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë; 2. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale; 3. Departamenti i Filozofisë; 4. Departamenti i Sociologjisë;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al




stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	5. Departamenti i Shkenca Politike. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit APS është DPPS, i cili në organigramën e institucionit është nën varësinë direkte të FShS. Departamenti ndër vite ka të angazhuar staf me kohë të plotë: • Viti akademik 2022-2023, 21 PAE (1 Prof Dr, 11 Prof. Assoc. Dr., 7 Dr. 2 Dr. ne proces). • Viti akademik 2023-2024, 21 PAE (1 Prof Dr, 13 Prof. Assoc. Dr., 5 Dr. 2 Dr. ne proces); • Viti akademik 2024-2025, 21 PAE (1 Prof Dr, 13 Prof. Assoc. Dr., 5 Dr. 2 Dr. ne proces). <i>GVJ konstaton se në strukturën organizative të FShS për vitin 2024 janë të deklaruar në strukturën akademike 23 anëtarë, që është i ndryshëm nga 21 anëtarëtë deklaruar në evidencën Tabelat përmbledhëse të RVB-së.</i> Sipas nevojave që ka DPPS, për çdo vit akademik angazhon edhe pedagogë të jashtëm. Angazhimi i staft të jashtëm miratohet nga Rektori. Angazhimi i pedagogëve të jashtëm ndërvite në programin Administrim dhe Politikë Sociale ka qenë: • Viti akademik 2022-2023, 18 PAK (1 Prof. Assoc. 2 Dr., 2 Dr. ne proces dhe 13 MSc); • Viti akademik 2023-2024, 17 PAK (1 Prof. Assoc. 4 Dr., 5 Dr. ne proces dhe 7 MSc); • Viti akademik 2024-2025, 19 PAK (1 Prof. Assoc. 3 Dr., 3 Dr. ne proces dhe 12 MSc) DPPS që ofron programin Bachelor “Administrim dhe Politikë Sociale” me kohëzgjatje tre vite akademike e me 180 kredite, për vitin akademik 2024-2025 ka në përbërjen e tij 21 pedagogë PAE, prej të cilëve 14 janë me tituj shkencorë dhe 5 janë me gradën Doktor, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor për të paktën shtatë pedagogëve në departament dhe me të paktën tre pedagogë me gradë shkencore ose titull shkencor. Edhe pse programi APS është hapur në vitin akademik 2009-2020, procesi i vlerësimit për akreditimin e tij zhvillohet për herë të parë dhe me Vendim të Dekanit të Fakultetit nr. 43, dt. 13.11.2024 miratohet GVB që ka në përbërje katër anëtarë të departamentit dhe një student, duke respektuar në këtë mënyrë edhe kriteret ligjore.
---	---




	<i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 2.5, Struktura Orgnizative e FShS; Evidenca 2 shtesë, VKM nr. 976, dt. 08.10.2009; Evidenca 4 shtesë, Tabela përmbledhëse e RVB-së; Evidenca 5 shtesë, Ngarkesa PAE/PAK sipas orëve në planin mësimor)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	DPPS si njësi bazë dhe përgjegjëse për realizimin e programit të studimit APS në mbështetje të detyrime ligjore në fuqi, krahas personelit efektiv akademik, angazhon edhe personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e praktikave mësimore të studentëve dhe orëve laboratorike. Në RVB shpjegohet se angazhohen laborantë pranë departamenteve, sekretar për procesin mësimor dhe punonjës nga zyra e IT-së së FShS. <i>(Evidenca 2.5, Struktura organizative e FShS; Evidenca 2.23, Politika për mbështetjen e studentëve)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	DPPS si njësi bazë dhe përgjegjëse për realizimin e programeve të studimit pjesë e departamentit cakton në detyrën e koordinatorit të programit një nga anëtarët e stafit akademik. Me vendim të përgjegjës të departamentit dhe me konfirmim në mbledhjen e departamentit janë caktuar nga një koordinators për secilin program studimi, përfshi këtu edhe programin e studimit APS. Në bazë të Rregullores së departamentit të PPS, koordinatori është përgjegjës për zhvillimin e programit dhe të praktikave mësimore, në përputhje me objektivat e tyre. Në bazë të Rregullores së programit të studimit APS, koordinatori ka në detyrë organizimin e punës mësimore, asiston përgjegjës të departamentit në monitorimin dhe zbatimin e planit mësimor, administron dosjet e dokumentacionit të programit të studimit, koordinon veprimtaritë e programit me palët e treta, etj. <i>GVJ rekomandon një unifikim të procesit vendimmarrës për emërimin e koordinatorit dhe detyrve të tij, sepse ka mospërputhshmëri e ndryshime mes asaj çka përcaktohet nga rregullorja e departamentit të PPS, e programit të studimit APS dhe vendim të marrë për caktimin e koordinatorit të programit.</i> <i>(Evidenca 3.3, Rregullore e Departamentit të PPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 3.11, Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit;</i>

	<i>Evidenca 3.12, Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit)</i>			
Konkluzione	<i>DPPS përmbush kriterin ligjor për numrin e anatërave në departament dhe për shpërndarjen e ngarkesës mësimore mes stafit akademik e ndihmës akademik PAE/PAK. Njëkohësisht përmbush detyrimin ligjor dhe kriterin e cilësisë për angazhimin e stafit ndihmës akademik dhe kooordinatorin e programit të studimit APS për monitorimin dhe realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit Ba në APS paraqitet informacioni i nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Ky informacion gjendet edhe në Rregulloren e FShS dhe në Kornizën konceptuale të programit të studimit Bachelor në APS. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi Bachelor në APS është i regjistruar në sistemin me kohë të plotë, me 3 vite akademike, 6 semestra dhe me 180 kredite. Programi i studimit e përmban planin mësimor, në të cilin përfshihet informacioni i plotë për ndarjen e lëndëve në semestra. Çdo lëndë ka të përcaktuar numrin e krediteve dhe orëve në auditor sipas llojit të aktiviteteve dhe orët për studimin individual. <i>(4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e	Në rregulloren e UT e më tej në Rregulloren e FShS dhe të programit të studimit APS gjendet informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve.




përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret për pranimin e studentëve të rinj gjenden edhe në vendimet e përvitshme që UT për pranimin e studentëve në ciklin e parë Bachelor. Nga të dhënat e përcjellë nga Sekretaria Mësimore dhe nga RVB për vitet akademike nga 2021-2024 nuk ka patur studentë të transferuar dhe të regjistruar si program i dytë studimi në programin e studimit APS. <i>Rekomandohet hartimi i një rregulloreje të vetme për procesin e transferimit të studimeve dhe regjistrimet e studentëve në programe të dyta, kjo për të unifikuar të gjithë informacionin dhe procedurat në një dokument, për ta bërë më të plotë atë dhe të mos i kemi të shpërndara në disa dokumenta të ndryshëm.</i> <i>(Rregullore e UT-së; Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.14, Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit në programin Ba në APS; Evidenca 4.9 Tabela përmbledhëse Aneks të RVB; Evidenca 25 shtesë, Tabelë me numrin e studentëve të regjistruar, çregjistruar dhe transferimet)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit APS përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e lëndës në leksione, seminare, laboratore e praktika. Njëkohësisht përmbajnë objektivat, temat për secilën javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, politikat e frekuentimit dhe pjesëmarrjen, si dhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomandueshme. Në këtë mënyrë, këto programe lëndore përmbajnë të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Rekomandohet që: 1. <i>Literatura e detyrueshme të jetë e gjitha në shqip, përsa mundësohet dhe jo në anglisht. Kjo meqë kemi të bëjmë me studentë në ciklin Bachelor.</i> 2. <i>Në mungesë të teksteve në gjuhën shqipe, leksionet e pedagogëve duhet të jenë patjetër pjesë e literaturës së detyrueshme, pasi ka lëndë që nuk i kanë ato, psh "Hyrje në të drejtën".</i> 3. <i>Në mungesë të teksteve në gjuhën shqipe, leksionet e pedagogëve mund të botohen edhe si cikël leksionesh duke mbrojtur të drejtën e tyre të autorit dhe duke deklaruar burimin ku janë mbështetur për përgatitjen e këtyre leksioneve.</i> 4. <i>Formati i syllabusit të jetë i njëjtë për të gjithë, të jetë një standard.</i>

	5. Pedagogët, kryesisht të brendshmit të përdorin adresa zyrtare për postën elektronike dhe jo private. Kjo gjë vërehet edhe në komunikimet mes anëtarëve të stafit administrativ. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Gjatë takimit në institucion me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë si dhe me stafin akademik e ndihmës akademik u shpjegua se me qëllim përmirësimin e syllabuseve, ato azhonohen për çdo vit të ri akademik nga titullari i lëndës, të cilët e japin prej disa vitesh atë (lëndën). Në rastin kur lënda jepet nga dy pedagogë, kryesisht pedagogu i dytë është i jashtëm dhe zhvillon seminarët. Në këtë rast, kemi një bashëpunim mes të dy pedagogëve për organizimin e seminarëve dhe ndryshimet e mundshme nuk bëhen më shumë se 20% nga syllabusi i një viti më parë. Përgjegjësia e vlerësimit të studentit është përgjegjësi e të dy pedagogëve të angazhuar. Në rast kur kemi grup lëndësh, diskutimi për syllabusin bëhet në grup pedagogësh. Syllabuset në fund të procesit të rishikimit, miratohet nga përgjegjësi i departamentit e dekani i fakultetit, më tej arkivohen në dosjen e tyre në departament. Ndërkohë siç e kemi vlerësuar më lart, plani mësimor i ndryshuar fillon zbatimin në vitin akademik 2024-2025. Aktualisht plani mësimor që po zbatohet nuk është i ndërtuar sipas kërkesave të akteve nënligjore. <i>(Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit APS në ciklin e parë Bachelor pasqyron informacion të plotë e të detajuar në lidhje me parashikimet dhe objektivat e tij. Syllabuset ndjekin procesin e azhornimit për çdo vit të ri akademik.</i> <i>Rekomandohet që syllabuset të përmirësohen në aspektin formal të tyre përmes përfshirjes vetëm të literaturës shqip dhe të leksioneve të pedagogut në literaturën e detyrueshme, si dhe standartizimin në formatit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit me Bachelor APS synon aftësimin e studentëve për t'u bërë pjesë e tregut të punës si administratorë socialë. Gërshetimi mes zhvillimit të teorisë në auditorë e praktikave mësimore i mundësojnë studentit pasqisjen me njohuritë e nevojshme për përvetësimin e dijeve. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave janë një ndihmesë për studentin për të rritur aftësitë profesionale drejt punësimit të tyre. <i>(Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 7.1, Plani mësimor i ndjekur 5 vite më parë; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi i studimit Bachelor në APS është i organizuar në lëndë, të shpërndara në 3 vite akademike, 6 semestra dhe me 15 javë për secilin semestër. Çdo lëndë ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve dhe orët mësimore të ndara në auditor (leksione e seminare) dhe për përgatitje individuale. Zbatimi i drejtë i planit mësimor dhe i syllabuseve mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit të deklaruar në rregulloren e programit dhe njëkohësisht i mundësojnë studentit të rrisin rezultatet e të nxënit për të rritur aftësinë e tyre për integrim në tregun e punës. <i>(Evidenca 3.6, Rregullore e programit Bachelor në APS; Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 7.1, Plani mësimor i ndjekur 5 vite më parë; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>




Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në planin mësimor dhe në programet lëndore jepet informacion i plotë për lëndët dhe organizimin e tyre. Raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit. Organizimi i seminareve i ndërthurur me leksionet ku shpjegohet teorikisht lëndë e më tej zhvillimi i praktikës mësimore nga studentët në institucione janë një mundësi e mirë për përthithjen e dijeve prej tyre. Në RVB shpjegohet se hartimi i këtij programi ka nisur mbi bazën e përvojave ndërkombëtare për programe të ngjashme. <i>(Evidenca 3.6, Regullore e programit Bachelor në APS; Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 7.1, Plani mësimor i ndjekur 5 vite më parë; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në APS synon që raporti midis formimit teorik dhe praktik të mundësojë arritjen e objektivave të tij. Njëkohësisht, organizimi i tij në lëndë me kredite mundëson transferimin apo mobilitetin e studimeve, duke ndihmuar studentin në përgatitje teorike e praktike për t'u punësuar në fund të procesit të studimit. <i>Studentët e këtij programi studimi nuk kanë marrë pjesë në projekte mobiliteti në vendet e BE-së, që e cila përbën një mangësi për programin.</i> <i>(Evidenca 3.6, Regullore e programit Bachelor në APS; Evidenca 4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit APS; Evidenca 4.2a, Planet mësimore të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 7.1, Plani mësimor i ndjekur 5 vite më parë; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 13, Lista e angazhimit të stafit dhe studentëve në programet mobility Erasmus)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë	DPPS zhvillon për çdo fillim viti akademik procesin e rishikimit të syllabuseve, me qëllim përmirësimin dhe azhornimin e tyre. Një pjesë e syllabuset kanë të pasqyruar si literaturë bazë, leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, gjë e cila rrit edhe më shumë nevojën për azhornimin e tyre. Siç është evidentuar edhe më lart, syllabuset kanë nevojë të bëjnë përmirësime për rritjen e cilësisë së tyre. Stafi akademik duhet të marrë në konsideratë që literatura e detyrueshme duhet të jetë e gjitha në shqip, pasi jemi në nivelin Bachelor dhe se




dhe ndihmëse të viteve të fundit.	leksionet e pedagogëve, apo rastet e tyre të studimit do të duhet të përfshihen formalisht edhe në literaturën e detyrueshme të syllabuseve. Biblioteka fizike dhe ajo online janë një ndihmesë dhe një mundësi e mirë për të realizuar përditësimin e syllabuseve. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 2.25, Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 2.27, Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën; Evidenca 34 shtesë, Botim i katër librave nga UT dhe universitetet partnere)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Ba në APS synon t'i vijë në ndihmë studentit në përfitimin e dijeve, rritjen e aftësive dhe kompetencave të tyre profesionale në mënyrë që të rrisin mundësitë e tyre për integrim në tregun e punës. Azhurnimi i përvitshëm i programeve lëndore me literaturë bashkëkohore janë ndihmëse e rëndësishme për ofrimin e dijeve të nevojshme për rritjen e aftësve të studentëve. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Bachelor APS ndihmon studentin në formimin bazë si administrator të politikave sociale dhe hap mundësi për thellimin e dijeve në studimet e mëtejshme në ciklin e dytë Master Profesional dhe/ose Master i Shkencave, si brenda dhe jashtë vendit. Nga të dhënat e punësimit të studentëve në këtë program studimit shohim se një pjesë e studentëve të diplomuar në programin APS kanë thelluar dijet në të njëjtën fushë studimit edhe në programet e ciklit të dytë Master i Shkencave. Përmirësimi i vazhdueshëm dhe azhurnimi i programeve lëndore mundëson rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të studentëve për t'u përshtatur gjithnjë e më shumë me kërkesat e tregut të punës. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.14b, Të dhëna për punësimin e studentëve)</i>
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit APS është në përputhje me nivelin e gjashtë të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve dhe të rezultateve të të nxënit. Programi bën ndarjen mes pjesës</i>

	teorike e praktike të tij duke ofruar një mundësi për studentët për të rritur aftësinë dhe kualifikimin e tyre. Azhurnimi i përvitshëm i programeve lëndore ndihmon në ofrimin e dijeve bashkëkohore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	RVB shprehet se në hartimin e programit të studimit APS departamenti ka marrë përvojë edhe nga programe të universiteteve ndërkombëtare në këtë fushë studimi. Përgjatë ecurisë së programit, përmirësimi i tij është realizuar përmes azhurnimeve të sylllabuseve dhe njëkohësisht përmes ndryshimeve të planit mësimor, <i>edhe pse ndryshim shumë i vonuar.</i> Përgjatë ecurisë së programit, DPPS ka organizuar aktivitete e tryeza të diskutimi, të cilat kanë patur për qëllim përmirësimin në nivel programesh në fushën sociale, por jo konkretisht për programin APS. <i>Vonesa për ndryshimin e planit mësimor sipas kërkesave ligjore shërben edhe si tregues mbi cilësinë dhe sasinë e përfshirjes të rezultateve nga konsulencat apo propozimet e mundshme të institucioneve partnere për të përafëruar kurikulën me kërkesat e tregut të punës.</i> Vlerë e shtuar në përmirësimin e kurrikulës është edhe studimi i tregut i realizuar nga anëtarë të stafit të departamentit. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.14a, Analizë e tregut të punës; Evidenca shtesë 32, Aktivitetet dhe feedback nga partnerët dhe tregu i punës për përmirësimin e kurrikulës)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe	Institucioni organizon për çdo vit akademik anketën me studentët për cilësinë e mësimdhënies në FShS, përmes së cilës ata shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre për programin e studimit. Mbi bazën e këtyre të dhënave, NjSBC harton

konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	raportin e gjetjeve nga anketimi dhe e përcjellë në departament. Zhvillimi i anketimeve të studentëve për përmirësimin e kurikulës është një përfshirje e drejtpërdrejtë e tyre në përmirësimin e programit të studimit. Kërkesa të studentëve ishin: • Shtimin e lëndëve të reja në program mbi komunikimin, administrimin, edukimin, proceset psikologjike, etj; • Më shumë lëndë praktike për të qenë më shumë kohë në organizata; • Rishikimin e lëndëve që kanë mbivendosje në program; • Lëndë që të jenë më pranë ngjarjeve aktuale sociale apo që hyjnë më thellë në analizë për zbatimin e politikave sociale. Është e rëndësishme që DPPA të ketë raporte specifike mbi kërkesat e studentëve për përmirësimin e kurikulës dhe mbi gjetjet e dala nga anketimi me studentët. Institucioni ka hartuar një pyetësor për studentët e diplomuar, por në të nuk ka pyetje që lidhen me përmirësimet e mundshme të programit të studimit APS. Në raportin analizë të NjSBC nuk ka të përfshirë opinionet e Alumni. <i>GVJ rekomandon që departamentet të shprehen në mënyrë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha ankimimet apo kërkesat e shprehur nga studentët, gjithnjë pasi janë diskutuar në mbledhjen e departamentit dhe të evidentohen zgjidhjet e mundshme që ju janë dhënë kërkesave të tyre.</i> <i>(Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022-2023; Evidenca 4.18b, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024; Evidenca shtesë 2.17, Raporte Periodike NjSBC 2023, 2024)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata,	DPPS, si njësia përgjegjëse e programit të studimit ka në praktikën e punës rishikimin e programeve lëndore në çdo fillim viti akademik me qëllim përmirësimin e tyre. GVJ vlerëson se kjo është e pamjaftueshme për përditësimin e programit. <i>GVJ rekomandon që departamenti të zhvillojë diskutime specifike për programin për përmirësimin e tij dhe jo vetëm në tërësi për programet në fushën e shkencave sociale.</i>

urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Po kështu, procesi i vjeljes së opinioneve e mendimeve të studentëve duhet të vijojë deri në fund me një analizë se çfarë bëhet me kërkesat e tyre, gjë e cila mund të sjellë edhe nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve të programit APS më shumë në anketime dhe në aktivitetet e departamentit. (Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022-2023; Evidenca 4.18b, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024)			
Konkluzione	FShS dhe DPPS kanë nxitur studentët të përfshihen në anketime për programin e tyre të studimit. Por duhet të angazhohen edhe më shumë për organizimin e takimeve konsultative me partnerët për kriteret dhe kërkesat e tregut për administratorë socialë, në mënyrë që rekomandimet e tyre, si dhe kërkesat e studentëve të sjellin ndryshime e përmirësime reale në programin e studimit APS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë të pasqyruara në syllabusët e lëndëve, ku është përcaktuar se forma e kontrollit të dijeve krahas frekuentimit, ku prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	është e detyrueshme në masën 75% për seminarët, zhvillohet edhe përmes kontrollit të vazhdueshëm si më poshtë: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në mësim 10%; • ese kritike 30%; • provim / test final 60%. Syllabusi ka të shprehur se leksionet janë fakultative dhe jo të detyrueshme për studentin, nga ana tjetër përcakton se nëse student pjesëmerr në seminare nga 50%-75% nuk ka të drejtë të futet në provimin e rradhës por kalon në sezonin e vjeshtës. Për pjesëmarrje nën 50% të seminareve, studenti humbet të drejtën për të hyrë në provim dhe përsërit lëndën vitin e ardhshëm. Në syllabuse vihet re se forma e frekuentimit dhe forma e kontrollit kanë ndryshime si në në përqindjen dhe pikë që zë secila nga format e mësimdhënies, kjo në varësi të vetë lëndëve. Ka lëndë që pjesëmarrjen e detyrueshme 75% e kanë si për leksionet edhe për seminarët dhe kur kjo realizohet studenti vlerësohet me një bonus 5% në vlerësimin final. Në këto lëndë, kontrolli i vazhdueshëm zhvillohet si më poshtë: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në mësim 10%; • ese kritike 20%; • provim i ndërmjetëm 15%; • provim / test final 55%. Rregullorja e FShS dhe Rregullorja e programit të studimit APS kanë të përcaktuar në mënyrë të njëjtë politikat e frekuentimit të cilat janë: • frekuentimi i leksioneve si rregull është fakultativ; • frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm mbi 75%; • nëse frekuentimi i seminareve është nga 50%-75% studenti nuk futet në provimin e rradhës, por kalon në sezonin e vjeshtës; • nëse frekuentimi i seminareve është nën 50%, studenti përsërit lëndën vitin e ardhshëm; • projektet e kursit janë të detyrueshme të shlyhen 100%, në të kundërt studenti nuk hyn në provimin e lëndës. Ndërsa vlerësimin përfundimtar të njohurive, rregulloret e sipërcituara e lënë në lirinë akademike të vetë pedagogut të lëndës, që e parashikon në syllabus të "Forma e kontrollit të dijeve". Rregullorja e FShS dhe e DPPS parashikojnë që studentët e kanë detyrim kryerjen 100% të orëve të praktikës mësimore. Rregullorja e FShS dhe e programit të studimit APS
--	--




	përcakton se studenti që nuk realizon programin e praktikës profesionale, i nënshtrohet rregullave si për të gjitha detyrimet e tjera. Për vlerësimin e praktikave profesionale krahas vlerësimit të angazhimit nga pedagogu mbikqyrës, studenti vlerësohet edhe nga mbikqyrësi në institucion. <i>Rekomandohet që të gjitha programet lëndore (syllabuset) të kenë të shprehur në mënyrë të standardizuar politikat e frekuentimit mbështetur në rregulloren e Fakultetit të ShS dhe të programit të studimit APS.</i> <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.3, Rregullore e DPPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.4, Dokumentat e Praktikës [Manual mbi praktikën profesionale]; Evidenca 12 shtesë, Model i dosjes së praktikës profesionale)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Format që përdorin pedagogët e lëndëve për zhvillimin e lëndës janë: 1. Mësimi i organizuar me leksione e seminare; 2. Përcjelljen dhe analizimin në auditor të studimeve dhe gjetjeve kërkimeve që ata kanë bërë. 3. Ftesa dhe pjesëmarrja e lektorëve të huaj e vendas përmes leksioneve të hapura mundëson përcjelljen e dijeve në auditor si një metodë alternative e mësimdhënies. Përgjatë takimit në institucion, pedagogët u shprehën se është në praktikën e tyre të punës që rezultatet e angazhimeve e bashkëpunimeve të tyre kombëtare e ndërkombëtare apo edhe të botimeve shkencore t'i përcjellin në auditor me studentët dhe njëkohësisht duke i ftuar ata (studentët) që të bëhen pjesë e tyre. Pedagogët deklaruan se kanë një ndërveprim mes tyre si në nivel departamenti edhe me bashkëpunime me stafin e departamenteve të tjera brenda FShS. Këto aktivitete u shprehën ata, kanë ndikuar në përmirësimin dhe azhurnimin e literaturës së syllabuseve. Përpos përfshirjes së stafit të DPPS në procesin mësimdhënës, në projekte dhe në punë administrative në departament, gjatë vizitës në institucion GVI konstatoi një angazhim e përgjegjësi të stafit për realizimin e procesit të mësimdhënies e mësimnxënies me sa më shumë cilësi e përfitim për studentët. Nga vlerësimet e bëra nga studentët për vitin akademik 2023-2024 semestri i parë, shihet një pjesëmarrje e ulët e studentëve të DPPS në anketim, vetëm 44% e studentëve në programet Bachelor. Por krahasuar me

	anketimin e një viti më parë, për vitin akademik 2022-2023 ku kishim një pjesëmarrje edhe më të ulët në aktiminin në 30% të studentëve të regjistruar, kemi rritje në pjesëmarrje në masën 14%. Në raportin e anketimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i parë, shohim se në nivel FShS 82.1% e studentëve shprehen se pedagogët e zotërojnë lëndën, 81.5% e tyre shprehen se pedagogët janë të përgatitur dhe 57.3% e studentëve bien plotësisht dakord për materialet e ofruara nga ana e pedagogëve. Ndërkohë në anketimin me studentët një vit më parë 2022-2023, studentët në nivel fakulteti janë të shprehur shumë të kënaqur në masën 75% për vlerësimin e arritjeve të tyre nga ana e pedagogut, 76% për organizimin e një mjedisi nxitës për mësimnxënie dhe 51% e studentëve të anketuar janë plotësisht dakord se pedagogu tregon respekt dhe nxit pjesëmarrjen në mësim. Në analizën e saj, NjSBC vë theksin në rëndësinë që duhet t'i japi stafi akademik e ndihmës akademik repektimit të orarit të mësimit dhe zhvillimin e konsultimeve me studentët sipas orareve të afishuara. GVJ rekomandon që: <i>1. DPPS të punojë më shumë me studentët për rritjen e pjesëmarrjes në anketim me synimin e një pjesëmarrje mbi 50% të tyre dhe për respektimin e detyrimeve ligjore të tyre të konstatuara në raportet e NjSBC, edhe pse në raste të kufizuara.</i> <i>2. NjSBC të përgatisë raporte analitike për secilin departament më vete e më tej mund të realizojë analiza sasiore krahasuese mes tyre.</i> <i>(Evidenca 4.12, Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Evidenca 4.17, Feeedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 [semestri i parë])</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me	Angazhimi i stafit akademik në projekte, programe mobiliteti, trajnime, bashkëpunime për realizimin e aktiviteteve me partnerë, apo edhe për përgatitjen e publikimeve shkencore janë një vlerë e shtuar për institucionin dhe stafin e angazhuar në të, që shërbejnë si një bazë themlore në përmirësimin e kompetencave profesionale e jo vetëm, me qëllim rrijen e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222 43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.asc.al




rezultatet e pritshme të të nxënit.	përpyqjeve për rezultate më të larta në procesin e gjatë të të nxënurit. Po kështu, edhe vjelja e opinioneve të studentëve me qëllim përmirësimin e procesit akademik, është tregues i qasjes së ka FShS për të përmirësuar kompetencat e stafit të tij. Në nivel universiteti, institucioni mbështet stafin e tij me një grant për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferencë ndërkombëtare një herë në dy vjet. Kjo mbështetje u vlerësua edhe nga vetë stafi i departamentit përgjatë takimit në institucion me GVJ. <i>(Evidenca 1.18, Vendim BA për miratimin e programit të grantit për konferencë ndërkombëtare; Evidenca 3.25a, Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve; Evidenca 4.9, Tabela përmbledhëse për trajnime profesionale; Evidenca 4.12, Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Evidenca 4.17, Feeback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 [semestri i parë]; Evidenca 13 shtesë, Lista e angazhimit të stafit dhe të studentëve në programet mobility Erasmus; Evidenca 34 shtesë, Botim i katër librave nga UT dhe universitetet partnere)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e	Nga analiza e CV-ve të stafit efektiv të departamentit shohim se janë me tituj e grada shkencore, se kanë qëndrueshmëri, përvojë të gjatë në fushën në të cilën ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përfshirje të plotë të tyre në procese të ndryshme për rritjen e kualifikimit të tyre. Edhe pse stafi i departamentit ka një ngarkesë më të lartë se norma, në takimin e GVJ në institucion, ata shfaqën përkushtimin e dëshirë për të zhvilluar e përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat e metodat interaktive në mësimdhënie. Stafi i DPPS në këtë takim deklaroi se vlerësimi i performancës së tyre për procesin e mësimdhënies zhvillohet çdo fund semestri nga studentët përmes një anketimi të organizuar nga NjZHC, apo edhe përmes fokus grupeve që i organizojnë vetë pedagogët e lëndës në mënyrë joformale me studentët për përmirësimin e procesit mësimdhënie-mësimnxënie. Në fund të çdo viti akademik pedagogu harton një raport vjetor për angazhimet e tij profesionale e akademik dhe sesa është

marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	respektuar marrëveshja vjetore e angazhimeve përgjatë vitit akademik, që ai e ka bërë me përgjegjësin e departamentit. Njëkohësisht, edhe Zyra e BNj kërkon në mënyrë të vazhdeshme përditësimin e CV-së së stafit të FShS. Përgjatë zhvillimit të orës mësimore të përshkruar në programet lëndore stafi akademik synon të nxisi një mendim kritik tek studentët dhe njëkohësisht të ndërtojë marrëdhënie bashkëpunimi e respekti të ndërsjellë. Në raportin e anketimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i parë, shohim se në nivel fakulteti, 57.3% e studentëve bien plotësisht dakord për materialet e ofruara nga ana e pedagogëve. Ndërsa në anketimin me studentët në nivel FShS një vit më parë 2022-2023, 51% e studentëve të anketuar janë plotësisht dakord se pedagogu tregon respekt dhe nxit pjesëmarrjen në mësim, pra treguesi ka një rrije në 6.3% <i>GVJ rekomandon që departamentet të shprehen në mënyrë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha kërkesat e shprehur nga studentët për përmirësimin e procesit mësimor, qofshin edhe kërkesa të kufizuara në numër e përqindje.</i> <i>(Evidenca 4.16, CV e personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm; Evidenca 4.6, Aneks Tabelat përmbledhëse; Evidenca 4.9, Tabela përmbledhëse për trajnime profesionale; Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 [semestri i parë]; Evidenca 3 shtesë, Tabela përmbledhëse e RVB-së; Evidenca 6.1, 6.2, 6.3, 6.4, 6.5 shtesë, Aktivitete me natyrë kërkimore 2019-2024)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar	FShS përmes DPPS dhe NjSBC zhvillon në mënyrë të përvitshme kontrolle për zbatimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të performancës së personelit të angazhuar në procesin e mësimdhënies, që shërben si një tregues i rëndësishëm ndihme për të ofruar një cilësi gjithnjë e në rritje në mësimdhënie nga ana e stafit akademik e ndihmës akademik. DPPS si njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit APS dhe stafit i tij përmes: procesit të rishikimit të programeve lëndore në fillim të çdo viti akademik;

mendimet e këshillat e tyre.	• organizimin e focus grupeve me studentë për përthithjen e mendimeve të tyre për lëndën; • përcjellja në auditor e mes pedagogëve e njohurive të reja që ata marrin përmes punimeve të reja shkencore apo e pjesëmarrjes në projekte; janë tregues që ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të stafit dhe të metodave mësimdhënese. Po kështu, përmes anketimit të studentëve në çdo fund semestri synohet vjelja e mendimeve të tyre për zhvillimin e procesit mësimor dhe për qasjen dhe performancën e pedagogut ndaj lëndës. Gjithsesi GVJ rekomandon që departamentet: 1. Të shprehen në mënyë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha kërkesat e shprehur nga studentët për përmirësimin e procesit mësimor. 2. Të bëjë vlerësim horizontal të stafit të departamentit në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të formave të mësimdhënies. (Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 4.17, Feeback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 [semestri i parë])
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe	Në bazë të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” në UT procesi i sigurimit të njësisë funksionon në tre nivele: • Në nivel universiteti, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e UT-së, e cila ka përgjegjësinë për zbatimin e strategjive, politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në nivel institucional; • Në nivel njësi kryesore, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e FShS, që ka për objekt pune monitorimin e procesit të mësimdhënies, si dhe çdo veprimtari akademike dhe administrative për zhvillimin e cilësisë dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të cilësisë, në përputhje me planin strategjik dhe misionin e njësisë kryesore.




zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	- Në nivel njësie bazë, përmes Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e departamentit, që ka për objekt pune planifikimin, organizimin dhe koordinimin e punës për vlerësimin e brendshëm të njësisë. Në RVB dhe në dokumentat shoqërues tregohet për funksionimin e NjSBC në nivel njësie kryesore, por jo njësie bazë. Ndërkohë që edhe vetë Rregullorja e FShS ka të shpjeguar ngritjen e NjSBC në nivel njësie bazë dhe detyrat e veprimtarinë që duhet të zhvillojë secila njësi. NjSBC në FShS, në nivel njësie kryesore është krijuar me Urdhër të Brendshëm të Dekanit nr. 14/2, dt. 15.07.2021. NjSBC është një strukturë e përhershme ndihmësakadematike me karakter administrativ, që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. NjSBC ka si mision të saj të planifikojë, organizojë dhe të publikojë veprimtarinë në kuadër të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe për programet e studimit që zbatohen në FShS. Kjo njësi, bashkëpunon me departamentet, si njësi përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, e cila reflektohet edhe në raporte e kontrollit periodik. NjSBC e FShS ka të ndarë detyrat dhe funksionet mes anëtarëve të saj dhe në raportet vjetore bën një analizë të të dhënave të gjeneruara nga anketimi me studentët në fund të çdo semestri. Njëkohësisht, me Urdhër të Dekanit nr. 3, dt. 12.05.2022 është ngritur Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme (KSCB) në FShS. Senati Akademik i UT-së me Vendim dt. 23.12.2020 ka miratuar Paketën e Instrumentave të Cilësisë ku përfshihen pyetësorë të ndryshëm për anketim të studentëve për vlerësimin e lëndës, për metodat e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies, etj. Anëtarët e departamentit të PPS janë angazhuar në projekte e mobilitete të ndryshme, por nuk ka informacion mbi aktivitetet e zhvilluara që ata të kenë marrë pjesë, qoftë edhe trajnime, që kanë patur për qëllim përmirësimin e aftësive të stafit në mësimdhënie dhe në zbatimin e metodave të reja. Gjithsesi GVJ konstaton si mangësi mungesat e dokumentave të cituara në RVB si: Evidenca 1.6, Rregullore “Për Sigurimin e Cilësisë” në UT-të;
---	--




	• Evidenca 1.6.1, Rregullore "Për funksionimin e NjSBC" në UT; • Evidenca 2.13, Rregullore e NjSBC të FShS. (Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" në UT; Evidenca 1.11, Manuali i Cilësisë; Evidenca 1.14, Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 1.14.1, Vendim i Senatit Akademik për dokumentat e sigurimit të cilësisë; Evidenca 2.12, Vendim i FShF për ngritjen e NjSBC; Evidenca 2.15, Të dhëna për NjSBC (Tabela 24) dhe GVB; Evidenca 2.17, Raporte periodike NjSBC 2023, 2024; Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 4.18a, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022-2023; Evidenca 4.18b, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024)			
Konkluzione	GVJ vlerëson se FShS dhe DPPS kanë ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme veprime konkrete për të garantuar procesin e të nxënit, aftësimin profesional të studentëve, duke u përpjekur të përfshijnë praktikat që kanë në qendër studentin, për të siguruar arritjen e rezultateve më të larta. Programet lëndore shpjegojnë në mënyrë të detajuar zhvillimin e procesit mësimor dhe metodat që aplikohen. DPPS dhe NjSBS do të duhet të rrisin edhe më shumë bashkëpunimin për rritjen e numrit të studentëve anketues dhe nga ana tjetër, rekomandohet që departamenti të përgjigjet në mënyrë ekspilice për kërkesat e studentëve për përmirësimin e procesit mësimor. NjSBC në bashkëpunim me DPPS ndërmarrin hapat e nevojshme për realizimin e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe arritjen e rezultateve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------


Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e FShS ka të përcaktuar strukturën e programit të studimit, komponentët mësimorë të programit, ndjekjen e veprimtarisë mësimore, kontrollin e dijeve dhe instrumenta të vlerësimit, për të vijuar me mënyrën e realizimit të provimeve, riprovimeve e përmirësimit të notës e deri në mbrojtjen e diplomës e tërheqjen e saj. Duke mundësuar në këtë mënyrë përfshirjen brenda rregullit të të gjithë procesit vlerësues së dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Në rregulloren e DPPS gjejmë të pasqyruar procedurën e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve, që lidhet me vlerësimin e praktikave pedagogjike, hartimin e tezës së provimit dhe zhvillimin e provimit. Rregullorja e programit të studimit Bachelor në APS në mënyrë të detajuar ka të shpjeguar të gjithë procesin e organizimit të studimeve dhe vlerësimit të studentit. Me vendim Dekani nr. 44, dt. 11.12.2024, FShS ka të miratuar edhe “Rregulloren e diplomimit në FShS në UT” për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, rregullat për organizimin e procesit, si dhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera në FShS dhe UT. Në ambientet fizike dhe rrjetet e komunikimi virtual të FShS publikohen aktet më të rëndësishme në procesin e vlerësimit të studentit, Njëkohësisht koordinatori i programit dhe pedagogët ua shpjegojnë këto rregulla studentëve në vazhdimësi. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS; Evidenca 3.3, Rregullore e DPPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në planin lëndor (syllabusin) e çdo lënde janë të pasqyruar rregullat dhe kritret për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve. Në fillim të çdo lënde dhe përgjatë zhvillimit të saj, pedagogu informon studentin për metodologjinë e testimit të njohurive e dijeve të marra nga student përgjatë zhvillimit semestral të lëndës. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive,	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve realizohet në forma të

dijeve dhe aftësi profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	ndryshme, për t'i dhënë më shumë mundësi shprehëse studentëve. Në syllabuset e lëndëve gjejmë të pasqyruar këto forma vlerësimi: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në mësim 10-30%; • ese kritike 10-30%; • provim i ndërmjetëm 10-20%; • provim / test final 60-90%. Ka pedagogë që vendosin edhe bonuse me pikë si një mjet nxinës për më shumë angazhim e pjesëmarrje nga ana e studentëve. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 3 shtesë, Tabela përmbledhëse e RVB-së; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Pjesëmarrja e studentëve në procesin e përmirësimit të formave e metodave të mësimdhënies zhvillohet në mënyrë periodike përmes plotësimit online të pyetësorit që është hartuar nga NjSBC dhe që përmirësohet vit pas viti. Zyra e IT e përcjellë elektronikisht tek studentët. Staf i DPPS në takim me GVJ deklaroi se vlerësimi i performancës së tyre për procesin e mësimdhënies zhvillohet çdo fund semestri nga studentët përmes një anketimi të organizuar nga NjSBC, apo edhe përmes fokus grupeve që i organizojnë vetë pedagogët e lëndës në mënyrë joformale me studentët për përmirësimin e procesit mësimdhënie-mësimnxënie. <i>GVJ rekomandon që departamentet të shprehen në mënyrë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha ankimimet apo kërkesat e shprehura nga studentët, gjithnjë pasi janë diskutuar në mbledhjen e departamentit dhe të evidentohen zgjidhjet e mundshme që ju janë dhënë kërkesave të studentëve.</i> <i>(Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022-2023; Evidenca 4.18b, Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024)</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e	Përcjellja e dijeve përgjete procesit të mësimdhënies e mësimnxënies organizohet në auditor gjatë leksioneve e

metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	seminareve, të cilët (auditorët) janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor si: video projektor e laptop, të cilat u konstatuan nga GVJ gjatë vizitës në institucion, <i>por që janë të dhëna që mungonë në dokumentin "Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16"</i>. Rregullorja e FShS dhe Rregullorja e programit të studimit APS kanë të përcaktuar në mënyrë të njëjtë se projektet e kursit janë të detyrueshme të shlyhen 100%, në të kundërt studenti nuk hyn në provimin e lëndës. Gjë që detyron studentët të kryejnë punë autonome grupi, si dhe shërben si një formë për të testuar dijet dhe procesin analitik të të menduarit. Tregues për matjen dhe vlerësimin e procesit mësimdhënës e mësimnxënës janë edhe përgjigjet e studentëve në anketimin e vitit akademik 2022-2023, të cilët në nivel fakulteti janë të shprehur shumë të kënaqur në masën 75% për vlerësimin e arritjeve të tyre nga ana e pedagogut, 76% për organizimin e një mjedisi nxitës për mësimnxënie dhe 51% e studentëve të anketuar janë plotësisht dakord se pedagogu tregon respekt dhe nxit pjesëmarrjen në mësim. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS; Evidenca 2.28, Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16; Evidenca 4.17, Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 [semestri i parë])</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar të gjithë bazën e nevojshme rregulative për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, të cilat gjejnë zbatim të plotë përgjatë të gjithë aktivitetit dhe procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Çdo program lëndor (syllabus) e ka të shprehur formën e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin përfundimtar të njohurive të studentëve. Pedagogu/ët e lëndës kanë liri akademike për të përcaktuar testimin e njohurive të studentëve. Përgjatë të gjithë kohës së vlerësimit të lëndës semestrale realizohet vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Të gjitha testimet kanë të përbashkët kontrollin e vazhdueshëm të dijeve përmes: • pjesëmarrjes dhe aktivizimit të studentit në mësim; • përgatitjes së esesë kritike individuale ose në grup; • provim/test final. Ka lëndë në të cilat organizohen edhe provime të ndërmjetme. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi i studentëve në programin e studimit APS zhvillohet në auditor. <i>Gjatë takimit në institucion, GVJ ju shpjegua se përgjatë provimit tezat nuk sekretohen, që çon që emri i studentit të jetë i ditur nga pedagogu që korigjon provimin. Kjo gjë bie në kundërshtim me Rregulloren e FShS, e cila shpreh se provimet me shkrim bëhen me fletë të sekretuara.</i> Në RVB theksohet se UT në bashkëpunim me AADF ka vënë në dispozicion sistemin CleanScore të korigjimit të provimeve nëpërmjet sistemeve informatike të teknologjisë, por nuk ka informacion nëse ky sistem përdoret edhe nga stafi e DPPS dhe stafi i programit të studimit APS. Është për t'u vlerësuar procedura në FShS, që i mundëson studentet përmes platformës <i>e-studenti</i> të regjistrohet vetë në provimin që kërkon të realizojë. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>

Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje të plotë me format e kontrollit të dijes që pedagogu ka përshtetur në syllabusin e lëndës dhe mbi bazën rregullative të institucionit. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.3, Rregullore e DPPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rregullorja e programit Ba në APS ka të përcaktuar se vlerësimi i njohurive, të dijeve dhe aftësive profesionale të studentit bëhen pas kryerjes totale të lëndës. Vlerësimi i detyrës së kursit bëhet përmes bashkëbisedimit pasi student/ët ka/kanë bërë prezantimin e projektit të punuar individualisht ose në grup. Komunikimi i vlerësimit të provimit (me shkrim / me gojë) bëhet nga pedagogu i lëndës dhe studenti ka 48 orë kohë për të ankimuar vlerësimin. Në rast ankimi, pedagogu thërret studentin dhe i komunikon vendimin e vlerësimit të lëndës ose të përgjigjen me shkrim për studentin pranë sekretarisë së departamentit. <i>(Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullorja e programit të studimit Ba në APS parashikon masa disiplinore ndaj veprimeve të ndëshkueshme si, plagjatura dhe kopjimi në provime e detyra. Staf i akademik orienton dhe këshillon studentët për realizimin e detyrave të kursit dhe temës së diplomës në përputhje me rregullat akademike të shkrimit, që të mos e kopjojnë apo të mos e kenë plagjaturë. <i>(Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS)</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rrezultatet e dhëna nga pedagogu për kontrollin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve bazohen në meritë. Në zbatim të Rregullores së programit të studimit Ba në APS, ky rezultat i komunikohet studentit brenda 10 ditëve dhe procesverbali i vlerësimeve dorëzohet në sekretarinë mësimore jo më vonë se 15 ditë nga data e provimit.
	<i>(Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur	Përmes rregullores së programit të studimit Ba në APS, institucioni u garanton të drejtën e ankimit studentëve për vlerësimin e lëndës. Studenti ka 48 orë kohë për ankimim note,

me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	më pas e humbit këtë të drejtë. Në rast ankimimi, pedagogu thërret studentin dhe i komunikon vendimin e vlerësimit të lëndës ose lë përgjigjen me shkrim për studentin pranë sekretarisë së departamentit. Studenti, përmes platformës <i>e-studenti</i> ka të drejtë të rishikojë tezën e provimit ose mund të bëjë kërkesë të drejtpërdrejtë për ta parë atë. <i>GVJ rekomandon që pedagogu të mund të organizojë në takim fizik me studentët, në një ditë e orë të caktuar, në të cilin mund të paraqiten të gjithë studentët që duan të shohin tezën e tyre fizikisht. Kjo formë mundëson transparencë më të plotë të tezës dhe procesit vlerësuar të provimit.</i> Rregullorja e FShS mbështet studentin dhe i garanton: 1. Të drejtën për ankimim për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, të përcjellë ankesë me shkrim pranë përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e provimit. Ankimimi shqyrtohet nga përgjegjësi i departamentit, i cili brenda 48 orëve verifikon nëse ka shkelje të korigjueshme. Nëse drejtuesi i njësisë bazë e gjykon se e ka të pamundur të marrë një vendim, problematikën e përcjellë tek Dekani, i cili nëse e vlerëson të drejtë ankesën e studentit, brenda 48 orëve merr vendim për anulimin e provimit dhe ripërsëritjen e tij. 2. Të drejtën për ankimin për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të njësisë bazë, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit të provimit. Drejtuesi i njësisë bazë pasi ka zbatuar rregullat me personelin akademik të lëndës, e përcjellë te drejtuesi i njësisë kryesore. Ky i fundit, ngre komisionin <i>ad hoc</i> që do të shqyrtojë ankimimin dhe brenda 3 ditëve pune del me vlerësim përfundimtar nëse qëndon apo jo ankesa e studentit dhe e përcjellë tek drejtuesi i njësisë kryesore, i cili e përcjellë për dijeni te drejtuesi i njësisë bazë, tek personeli akademik i lëndës dhe tek studentit. <i>GVJ rekomandon unifikimin e procesit të ankimimit të rezultatit përfundimtar të provimit pasi ka ndryshime midis rregullores së njësisë kryesore dhe rregullores së programit të studimit.</i> <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS)</i>
--	---

Konkluzione	<i>Përmes akteve rregullative, FShS i ka siguruar studentit vlerësim të drejtë, transparent e të bazuar në meritë. Po kështu, i ka garantuar të drejtën e ankimimit për vlerësimin e dijeve dhe për procedurën e zhvillimit të provimit.</i> <i>GVJ rekomandon unifikimin e procesit të ankimimit të rezultatit përfundimtar të provimit pasi ka ndryshime midis rregullores së njësisë kryesore dhe rregullores së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit APS ndërthur njohuritë teorike me elementët praktikë, me qëllim zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në mënyrë të veçantë si administratorë sociale. Në syllabuset e lëndëve kjo është pasqyruar edhe në mënyrën e vlerësimit ku të gjitha lëndët kanë të detyrueshme për studentin realizimin e një detyre kurse apo eseje kritike që vlerësohet nga 20% - 30% e totalit maksimal të pikëve. Po kështu, edhe praktika mësimore është një element i rëndësishëm për të zhvilluar më tepër aftësitë praktike të studentëve e vlerësuar me 6 ECTS. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit përmes lëndëve: Hyrje në politika sociale, Teoritë e ndryshimit social, Sjellje Organizative, Politika sociale ndërkombëtare, Shprehjet e komunikimit, Politikat e mbrojtjes sociale, etj, ju garantojnë studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. Ndërkohë që në planin mësimor programi nuk ka lëndë specifike në fushën e teknologjisë së informacionit (TI).

	GVJ rekomandon përfshirjen në planin mësimor të një lëndë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke marrë në konsideratë zhvillimet e vazhdueshme të TI-së dhe përfshirjen e saj gjithnjë e më shumë në çdo fushë studimi e veprimi në përditshmërinë tonë. <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në zbatim të rregulloreve të FShS, të DPPS dhe të programit të studimit APS, si dhe në bazë të syllabuseve të lëndëve, kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në çdo lëndë vlerësohen përgjatë zhvillimit dhe në përfundim të lëndës. Njëkohësisht, punimi dhe prezantimi i detyrave të kursit individualisht apo në grup janë një mundësi e mirë për analizën dhe evidentimin e aftësive që studenti ka përthithur e përvetësuar përgjatë procesit mësimor. Në RVB shpjegohet se në përfundim të lëndës pedagogu bën edhe një përmbledhje për efekt orientimi e përsëritje të çështjeve e koncepteve kyçe të trajtuara gjatë semestrit, si dhe orienton studentët për provimin përfundimtar të lëndës. Njëkohësisht koordinatori dhe pedagogët e programit orientojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme për njohjen dhe zbatimin e të gjitha rregullave për realizimin me suksese të detyrimeve përmbyllëse. <i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 3.3, Rregullore e DPPS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit të studimit APS; Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe	Syllabuset e lëndëve kanë të paqyruar kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët në përfundim të lëndës. Njohuritë për lëndën ata i marrin përgjatë leksioneve, seminareve, punimeve të detyrave të kursit dhe praktikës profesionale. Pedagogët e lëndëve inkurajojnë punën në grup për detyrat e kursit, organizojnë diskutime në seminare dhe njëkohësisht përcjellin në auditor rezultatet e studimeve të tyre apo zhvillimet e fundit në fushën e lëndët që ata zhvillojnë. Ndërtimi i laboratorëve të rinj do të shërbejë si një ndihmesë plus për ofrimin e njohurive praktike tek studentët. FShS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me partnerë vendas e

zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	ndërkombëtarë dhe organizon aktivitete të ndryshme me ta. Por megjithatë, nuk kemi patur mobilitete të studentëve të programit APS në universitetet partnere. GVJ rekomandon: <i>1. Lëndët që kanë të përfshirë dy orë leksion dhe një orë seminar të kenë të pasqyruar në rubrikën “Temat e lëndës”, krahas temës së leksionit edhe materialet që do të trajtohen në seminare, pasi ky informacion mungon te syllabuset.</i> <i>2. Nxitjen dhe përfshirjen e studentëve në programet e mobilitetit.</i> <i>(Evidenca 4.3, Programet lëndore të lëndëve të programit të studimit Ba në APS; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2023-2024; Evidenca 10.1 shtesë, Programet e lëndëve 2024-2025)</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Ftesa dhe pjesëmarrja e lektorëve të huaj e vendas përmes leksioneve të hapura mundëson përcjelljen e dijeve në auditor si një metodë alternative e mësimdhënies. Po kështu, stafi i DPPS ka një qasje pozitive për të përcjellë në auditor gjetjen e studimeve e punimeve të tyre kërkimore shkencore, apo edhe publikimet e reja. Studentët mbështeten dhe nxiten të angazhohen me punime në konferenca dhe aktivitete të organizuara nga DPPS. <i>(Evidenca 4.7, Të dhëna të plota për kërkimin shkencor 2021-2024; Evidenca 3.24, Tabela me aktivitete)</i>			
Konkluzione	<i>FShS ka strukturën e duhur institucionale dhe ka një staf të kualifikuar e të motivuar për të punuar në mënyrë të vazhdueshme për të promovuar dhe realizuar rritjen dhe përmirësimin e cilësisë në proceset mësimdhënie e mësimnxënie në programin e studimit APPS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Me vendim Dekani nr. 44, dt. 11.12.2024, FShS ka të miratuar “Rregulloren e diplomimit në FShS në UT” për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, rregullat për organizimin e procesit, si dhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera në FShS dhe UT. Rregullorja e programit të studimit Bachelor në APS në mënyrë të detajuar ka të shpjeguar të gjithë procesin e organizimit të studimeve dhe vlerësimit të studentit deri në realizimin e detyrimeve përmbyllëse. Njëkohësisht ajo ka të përcaktuar se studenti për të përfituar të drejtën për të realizuar temë diplome duhet të ketë notë mesatare 9 (nëntë) deri në përfundim të semestrit të katërt të studimeve. <i>(Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Në rregulloren e programit të studimit BA në APS dhe në atë të diplomimit në FShS gjendet informacioni i plotë mbi procesin e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Njëkohësisht, DPPS ka hartuar edhe Udhëzuesin për punimin e diplomës për të gjitha programet që ofron ky departament, ku në mënyrë të detajuar paraqitet i gjithë informacioni i nevojshëm në funksion të realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Të gjithë studentët që plotësojnë kriterin për temë diplome dhe zgjedhin ta realizojnë atë, propozojnë dy kandidatë për udhëheqës dhe në fund, është departamenti që merr vendim për zgjedhjen e udhëheqësit të punimit të temës nga studenti. Pedagogu udhëheqës ka detyrim konsultimet e vazhdueshme me studentin për shkrimin e punimit, si përgjatë takimeve edhe me formën e komenteve mbi dokumentin e punimit të temës që i përcjellë studenti. Përgjatë asistimit, udhëheqësi ka për detyrë t’i ofrojë studentit mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë studentit të arrijë standarde të larta të punimit. Për të gjithë studentët që do të realizojnë detyrimet përmbyllëse me provim formimi, departamenti për çdo vit harton pyetjet e provimit të formimit që miratohen nga Dekani i fakultetit. DPPS organizon orë informimi dhe këshillime për të orientuar studentët për rregullat që ata duhet të ndjekin në funksion të detyrimeve përmbyllëse.

	<i>(Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS; Evidenca 4.5, Paketa për përgatitjen e temës së diplomës dhe pyetjet e provimit të formimit)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Rregullorja e diplomimit të FShS ka të përcaktuar informacionin për provimit final. Fondi i pyetjeve i provimit të formimit përcaktohet nga departamenti, miratohet nga përgjegjësi i tij dhe më tej përcillet për miratim final te Dekani. Përzgjedhja e pyetjeve në tezën e provimit bëhet nga Komisioni i provimit final i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë dhe bazohet mbi fondin e pyetje që përfshijnë kryesisht njohuri nga lëndët e veprimtarisë formuese A dhe B. Provimi i formimit bëhet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur rregulli e parashikon ndryshe. Të dyja rregulloret e sipërcituara nuk përcaktojnë sesi dhe kush e zhvillon procedurën e korigjimit të provimit final dhe as RVB. <i>GVJ rekomandon njehsimin e rregullit për sezonet e mbrojtjes së diplomës. Rregullorja e Diplomimit në FShS ka të përcatuar 3 (tre) sezona dhe një sezon të veçantë të katërt nëse ka kërkesë nga Këshilli Studentor i Fakultetit, data e të cilave (sezoneve) miratohen nga Dekanati.</i> <i>Ndërsa rregullorja e programit të studimit BA në APPS përcakton se mbrojtja e diplomës bëhet në dy sesion, që përcaktohen në strukturën e studimeve.</i> <i>(Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS; Evidenca 4.5, Paketa për përgatitjen e temës së diplomës dhe pyetjet e provimit të formimit)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e	Punimi i diplomës është një punë kërkimore individuale e studentit që realizohet nën orientimin e udhëheqësit të diplomës. Drejtuesi i DPPS në bashëpunim me personelin akademik të departamentit dhe koordinatoren e programit në fillim të vitit akademik hartojnë listën e temave të provimit të diplomës. Udhëheqësi i diplomës i orienton studentët në zgjedhjen e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e temës së diplomës në bazë të rregullave që ka institucioni. Asistenca dhe mbështetja e udhëheqësit shërben si një garanci për cilësinë e punimi. Në fund të punës, studenti përcjell punimin e diplomës për miratim tek udhëheqësi, i cili

rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	e miraton ose jo për t'u paraqitur para komisionit të mbrojtjes së diplomës. <i>(Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS; Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS; Evidenca 4.5, Paketa për përgatitjen e temës së diplomës dhe pyetjet e provimit të formimit)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizeve, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	FShS në bashkëpunim me DPPS kanë vënë në dispozicion të studentëve ambientet e bibliotekës dhe kompjuterat që ajo disponon për realizimin praktik të punimit të diplomës. Studenti ka mundësi që në bibliotekën e FShS të përdorë edhe fondet fizike dhe elektronike të saj në bazë të temave të studimit që ata kanë. <i>(Evidenca 2.24, Rregullore e bibliotekës)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e diplomimit dhe e programit të studimit BA në APS përcakton qartë se studenti për detyrimet përmbyllëse qoftë me provim të përgjithshëm përfundimtar apo edhe me temë diplome vlerësohet në fund me notë. Për provimin e përgjithshëm përfundimtar, vlerësimi i studentit bëhet sipas sistemit të vlerësimit me 10 (dhjetë) nota. Nota më e ulët kaluese është 5 (pesë) dhe më e lartë është 10 (dhjetë). Për punimin e diplomës, vlerësimi i studentit kryhet fillimisht me pikë sipas skedës së vlerësimit të punimit të diplomës e më pas pikët konvertohen me notë. Nota shënohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave, i cili përcillet në sekretarinë mësimore të FShS nga kryetari i komisionit të provimit të diplomës. <i>(Evidenca 2.11, Rregullore e diplomimit në FShS)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje	Programi i studimit BA në APS ka kohëzgjatje 3 vite akademike dhe ka 180 kredite. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe që ka mbrojtur tezën e diplomës apo provimin e formimit, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit dhe me suplementin e diplomës, sipas formateve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kandidati që nuk fiton mbrojtjen e diplomës për herë të dytë pajiset me një dëshmi ku lihet shënimi: "Specialist i padiplomuar" dhe paraqiten rrezultatet e arritura gjatë viteve të studimit. Në përfundim të studimeve, studenti ka të drejtë të paraqesi kërkesë për t'u

e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	pajisur me kopjen e plotë të programit të studimit dhe më pas pajiset me kopjen zyrtare të syllabuseve për të gjitha lëndët që ai ka zhvilluar. <i>(Evidenca 3.6, Rregullore e programit BA në APS; Evidenca 3.10, Suplementi i diplomës dhe modeli i diplomës)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Mbështetur në legjislacionin në fuqi, në respektim të rregullave të brendshme të FShS dhe në dokumentacionin që na u vendos në dispozicion nga sekretaria mësimore e fakultetit gjatë vizitës së GVJ në institucion, u kostatua se FShS ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve. Të dhënat e studentëve ruhen në: • regjistrin e regjistrimit të studentëve gjatë pranimi të tyre në universitet; • regjistrin themeltar dhe të diplomave, që është një dokument i vetëm; • regjistrin e arritjeve akademike; • regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave; si edhe në • sistemin elektronik të të dhënave të studentëve në nivel fakulteti e në dosjet fizike me dokumentacionin e regjistrimit apo çregjistrimit të studentëve. FShS po punon me hedhjen e të dhënave në sistem dhe tashmë shumica e tyre dalin nga sistemi, që nga firma digjitale e deri te lista e notave apo lista e studentëve. FShS administron, mbron, ruan, siguron të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. <i>(Evidenca 2.9, Rregullore e Sekretarisë mësimore)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se FShS dhe DPPS ka mirëpëcaktuar të gjithë procesin e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Stafi i departamentit së bashku me përgjegjësin e koordinatorin e DPPS dhe në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore koordinojnë të gjitha aktivitetet dhe afatet për njoftimit e studentëve dhe për realizimin e përmbylljes nga ana e tyre të të gjitha kërkesave të ligjeve në fuqi dhe të rregullave të institucionit për përmbylljen e studimeve në programin BA në APS. Njëkohësisht Sekretaria mësimore në bashkëpunom me DPPS për plotësimin e të gjithë dokumentacionin të përcaktuar ligjor

	<i>me të cilin pajiset studentit pasi ai ka plotësuar të gjitha detyrimet përmbledhëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																												
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																												
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																											
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale (DPPS) përmbush kërkesat ligjore në fuqi sa i takon nivielit të kualifikimit akademik të personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe mbulimit përkatës sipas fushave mësimore të personelit në realizimin e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale. Gjithashtu, të dhenat e Personelit akademik të angazhuar për programin e studimit, për V.A 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 janë si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2022 – 2023</th></tr> <tr> <th>PAE</th><th>PAK</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr> <tr> <td>Prof. As. Dr</td><td>10</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Dr/PhD</td><td>7</td><td>2</td></tr> <tr> <td>Msc</td><td>1</td><td>15</td></tr> <tr> <td>Në total</td><td>19</td><td>18</td></tr> </tbody> </table> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Tituj/grada</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>		Tituj/grada	2022 – 2023		PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	Prof. As. Dr	10	1	Dr/PhD	7	2	Msc	1	15	Në total	19	18	Tituj/grada	2023 – 2024				
Tituj/grada	2022 – 2023																											
	PAE	PAK																										
Prof. Dr	1	-																										
Prof. As. Dr	10	1																										
Dr/PhD	7	2																										
Msc	1	15																										
Në total	19	18																										
Tituj/grada	2023 – 2024																											

	<table><tr><td></td><td>PAE</td><td>PAK</td></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. As. Dr</td><td>12</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>5</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>14</td></tr><tr><td>Në total</td><td>19</td><td>19</td></tr></table>		PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	Prof. As. Dr	12	1	Dr/PhD	5	4	Msc	1	14	Në total	19	19		
	PAE	PAK																			
Prof. Dr	1	-																			
Prof. As. Dr	12	1																			
Dr/PhD	5	4																			
Msc	1	14																			
Në total	19	19																			
	<table><tr><td rowspan="2">Tituj/grada</td><td colspan="2">2024 – 2025</td></tr><tr><td>PAE</td><td>PAK</td></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. As. Dr</td><td>12</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>5</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>15</td></tr><tr><td>Në total</td><td>19</td><td>19</td></tr></table> (Tabela 6.1; 6.2; 6.3 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit; Tabela Nr. 7 - Cilësia e stafit mësimdhënës të programit të studimit; Evidenca Nr. 4.16 - CV e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit)	Tituj/grada	2024 – 2025		PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	Prof. As. Dr	12	1	Dr/PhD	5	3	Msc	1	15	Në total	19	19
Tituj/grada	2024 – 2025																				
	PAE	PAK																			
Prof. Dr	1	-																			
Prof. As. Dr	12	1																			
Dr/PhD	5	3																			
Msc	1	15																			
Në total	19	19																			
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë në programin e studimit Bachelor në Admisnitrim dhe Politikë Sociale nuk mbulon ngarkesën e këtij programi studimi sipas raportit 70 PAE ME 30 PAK në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, LAL 80/2015 dhe VKM Nr.418/2017. DPSS për programin APS angazhon staf të brendshëm dhe të jashtëm sipas raportit (PAE/PAK) për ngarkesën mësimore (orë në auditor) sipas planit mësimor (Tabela 12) si më poshtë vijon: • Viti akademik 2022-2023, 58 %, PAE dhe 42% PAK; • Viti akademik 2023-2024, 56 %, PAE dhe 44% PAK; • Viti akademik 2024-2025, 60 %, PAE dhe 40% PAK. <u>GVJ sugjeron që departamenti të marrë masat për shtimin e ngarkesës së stafit PAE në mbulimin e programit për të përmbushur detyrimin ligjor për shpërndarjen e orëve në auditor mes pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në programe studimit APS.</u>																				

	<i>(Evidenca 2.4, Rregullore e FShS; Evidenca 2.5, Struktura Orgnizative e FShS; Evidenca 4 shtesë, Tabela përmbledhëse e RVB-së; Evidenca 5 shtesë, Ngarkesa PAE/PAK sipas orëve në planin mësimor)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	FShS garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin BA në APS në konformitet me statusin e UT në lidhje me punësimin si dhe anagzhimin e stafit dhe qëndrueshmërinë e ti gjatë periudhave të akreditimit. Sipas verifikimit të dosjes dhe materialeve mbështetëse struktura e stafit efektiv të programit të studimit BA në APS nuk paraqet ndryshime dhe ka një qarkullim të ulët të tij. <i>(Tabela. Nr. 12.1 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik; Tabela. Nr. 12.2 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik; Evidenca 2.18 - Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit; Evidenca 4 shtesë, Tabela përmbledhëse e RVB-së; Evidenca I.2 – Statuti UT (Neni 67-79))</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi bazuar në dokumentacionin e dosjes si dhe pyetjet gjatë vizitës në institucion se procedurat e rekrutimit të personelit akademik të punësuar pranë FShS janë konform me statin dhe aktet e Universitetin të Tiranës dhe janë në përputhje me kuadrin ligjor ën fuqi si dhe akteve rregulatore të IAL. FShS garanton një iter procedural sa i takon punësimit të personelit akademik sipas një procesi transparent, që nga kërkesa e DPPS sipas nevojave specifike, miratimi i Dekanatit, miratimi në Rektorat ut dhe shpallja në Buletinin e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare të UT. <i>(Evidenca I.2 – Statuti UT (Neni 67-79); Evidenca 1.12 - Manuali për punësimin e personelit në UT; Evidenca 2.18 - Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e	Programi BA APS për shkak të naturës së programit nuk ka të parashikuar orë laboratorike në planin mësimor.

laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Fakulteti i Skencave Sociale si pjesë përbërëse e Universitetit të Tiranës, bazuar në Statutin e saj administron të dhënat përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të cilat janë strukturat përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe akteve të brendshme rregullative. Dosja përmban listën e dokumentacionit në përputhje me LAL dhe Rregullores së Brendshme të FSHS dhe Rregulloren e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. <i>(Evidenca 1.8 - Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.; Evidenca 1.2 – Statuti UT (Neni 67-79; Evidenca 1.12 - Manuali për punësimin e personelit në UT)</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se FSHS ka një numër të lartë marrëveshesh me institucione, dhe organizata për realizimin e praktikës mësimore për programin e studimit BA APS, ku disa prej tyre: Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Bashkisë Tiranë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijës, OSCE, Shoqata Komuniteti Papa Xhovani, Save the Children, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit etj. Gjithashtu, departamenti DPSS angazhon çdo vit 4 (katër) anëtarë PAE për të garantuar tutoriatin, supervizimin dhe mbikqyrjen e studentëve lidhur me realizimin e praktikës profesionale. Gjithashtu, DPSS ka të anagzhuar pedagogë të anagzhuar staf PAE për ndjekjen e studentëve në kryerjen e punimit të diplomës sipas një procedurë të përcaktuar. <i>(Evidenca (shitesë) 11 – Lista e marrëveshjeve për realizimin e praktikës profesionale; Evidenca 3.19 – Raporti periodic analitik i përfutimit të marrëveshjeve; Evidenca 4.4. – Manuali I praktikës mësimore; Evidenca 4.5. – Paketa për përgatitjen e</i>

	<i>temës së diplomës dhe provimit të formimit; Tabela 5 – Anerks Tab. Përmbledhese – Intitucionet dhe orhganizatat për praktikat profesionale)</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	DPPS disponon një sistem efikas informacioni për orientimin e studentëve gjatë gjithë ciklit të jetës së studentit, përmes trajnimit orientues në një proces periodik deri në fund të studimeve. DPPS ka të angazhuar personel akademik (kriteri 7) të kualifikuar për ndjekjen dhe mbikqyrjen e praktikës profesionale të studentëve. Gjithashtu, garantohet nga personeli pritës në institucionet dhe organizatat ku zhvillohet praktika mësimore asistimi i studentëve në përmbushjen e detyrave operacionale gjatë zhvillimit të praktikës. Mbikëqyrsi I praktikës përpilon dhe Formularin e vlerësimit I cili është pjesë e marrëveshjes për realizimin e praktikës si dhe e përcaktuar dhe në Manualin e praktikës profesionale. <i>(Evidenca (shitesë) 11 – Lista e marrëveshjeve për realizimin e praktikës profesionale; Evidenca 4.4. – Manuali i praktikës mësimore; Evidenca 4.5. – Paketa për përgatitjen e temës së diplomës dhe provimit të formimit)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ky kriter nuk përmbushet plotësisht pasi FSHS dhe DPSS si njësi bazë përgjegjëse për programin ka të angazhuar Personel akademik që përmbush standardet cilësore por, <u>GVJ sugjeron</u> që departamenti të marrë masat për shtimin e ngarkesës së stafit PAE në mbulimin e programit për të përmbushur detyrimin ligjor për shpërndarjen e orëve në auditor mes pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në programe studimit APS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	FSHS dhe DPSS përgjegjës për programin e studimit disponojnë një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor por dhe jetës së studentit me kushtet e një

përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	kampusi: 6 salla për leksione; 16 salla për seminare; 2 salla për aktivitete promovuese; 1 sallë për praktikën profesionale; 1 sallë internet; 2 salla për bibliotekën etj. Godina universitare me 4 (katës) kate është e përshtatshme me mjedise moderne, me 3 (tre) Aula Magna, 6 (gjashtë) salla leksionesh, si dhe 16 salla për zhvillimin e seminareve. FSHS plotëson të gjitha kushtet e normativës (2.7 m2 për student) së VKM 418/2017, sa i takon hapësirës, systemin e ngrohjes qendrore (godina e rikonstruktuar), kondicionimit, kushtet higjieno sanitare, ndricimit natyral si dhe sistemin e mbrotjes kundra zjarrit. Veprimtaria mësimore e programit ushtrohet në Godinën 4 katëshe të FSHS. <i>(Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	FSHS dhe DPSS përgjegjëse për programin e studimit disponojnë faciliitetet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor ku në cdo sallë ka video-projektorë dhe ku në 5 (pesë) salla ka të vendosuar dhe smartboards. Për aktivitetet e vecanta me karakter ekstrak-kurikular si konferenca, open lecture apo tjera ka në përdorim dhe Aula Magna me një kapacitet ulës 100 vende. <i>(Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të	Programi BA APS për shkak të natyrës së programit nuk ka të parashikuar orë laboratorike në planin mësimor dhe ndaj nuk ka të nevojshme ekzistencën e laboratorëve ose pajisjeve specifike për realizimin e programit.




programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	FSHS ofron përmes bibliotekës 15 poste të pajisura me PC dhe programet softëare specifike si SPSS për përdorim nga studentët të cilët kanë akses dhe në literaturën dhe fondin e bibliotekës, punimet e diplomës së studentëve ndër vite me qëllim kerkim zhvillimin e tyre në funksion të programit të studimit. GVJ konstaton se salla e bibliotekës me 15 vende të ulura është e pamajftueshme për zhvillimin e orëve të seminareve për module si Metodatat e Kërkimit Social në raport me numrin mesatar të studentëve. Gjithashtu, GVJ u vu në dijeni të sallës së re TIK që është buxhetuar që në vitin 2024 dhe që po ndërtohet në fazë të avancuar drejt përfundimit. GVJ rekomandon përfundimin e sallës së TIK në shërbim të studentëve për realizimin e orëve të metodave të kërkimit social. <i>(Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën; Evidenca 2.25 – Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 4.10 – Të dhëna për burimet e literaturës; Evidenca 2.26 – Buxheti për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën; Evidenca shitesë 33 – Shkresa dhe buxheti pajisje me laborator TIK)</i>			
Konkluzione	Kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi FSHS ka siguruar mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale të përputhshme si për formimin teorik apo atë praktik. GVJ rekomandon përfundimin e sallës së TIK në shërbim të studentëve për realizimin e orëve të metodave të kërkimit social.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	DPPS u vë në dispozicion studentëve të Programit të studimit BA në APS për garantimin e njohurive literaturë e detyrueshme dhe ndihmëse. Përveç teksteve dhe literaturës në hard copy studentët mund të aksesojnë fondin fizik të bibliotekës në koleksionin e Punës Sociale si dhe kanë mundësi aksesit të barabartë dhe në burime online., të tilla si: COBISSAL; Publications/UNRISD; Cultivate your knowledge; Openedition Journals; EuroPS-Services që janë open source dhe pa limit. Gjithashtu, <i>GVJ sugjeron që në literaturën e detyrueshme të moduleve/lëndëve përveç përmbledhjes së leksioneve të pedagogëve, teksteve në anglisht, të punohet për të përfshirë tekste mësimore të botuara në gjuhën shqipe.</i> Nga raportimi i drejtuesve të departamentit dhe stafit, u informuam se janë botuar 4 tekste në gjuhën shqipe: Hyrje në Praktikën e punës me grupe; Metodatat e kërkimit social; Bazat e menaxhimit të rastit; Praktika e Punës Sociale. <i>(Evidenca 4.3 – Programet e lëndëve; Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën; Evidenca 2.25 – Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 4.10 – Të dhëna për burimet e literaturës; Evidenca 2.26 – Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	FSHS dhe DPPS ka një procedurë lidhur me përditësimin e literaturës përmes botimeve të fundit. Propozimet e njësive bazë miratohen sipas procedurave të UT. Pasurimi i fondit të bibliotekës ka një zë të vecantë në buxhetin vjetor të UT. Gjithashtu, fondi i bibliotekës pasurohet dhe përmes donacioneve si Fondacioni Soros, UNICEF, Ambasada Franceze. <i>(Evidenca 2.26 – Buxhetimi për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	DPPS u vë në dispozicion studentëve të Programit të studimit BA në APS për garantimin e njohurive me literaturë përdorimin e bibliotekës e cila funksionon për të gjithë studentët nga ora 08.00-18.00. Studentët mund të aksesojnë fondin fizik të bibliotekës në koleksionin e Punës Sociale si dhe kanë mundësi aksesit të barabartë dhe në burime online., të tilla si: COBISSAL; Publications/UNRISD; Cultivate your

	knoëledge; Openedition Journals; EuroPS-Services, që janë open source dhe pa limit. <i>(Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën; Evidenca 2.25 – Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 4.10 – Të dhëna për burimet e literaturës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën)</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Studentët mund të aksesojnë bibliotekën e cila ka një sipërfaqe 200m2, 74 poste dhe katër mjedise: sallën multimediale të pajisur me 8 PC, sallën e leximit me libra me fond të hapur, sallën e fondit të mbyllur dhe zyrën e përpunimit të koleksioneve. Studentët mund të përdorin fondin fizik të bibliotekës duke shfrytëzuar koleksionin e psikologjisë, punës sociale etj., si dhe kanë mundësi aksesit të barabartë dhe në burime online., të tilla si: COBISSAL; Publications/UNRISD; Cultivate your knoëledge; Openedition Journals; EuroPS-Services që janë open source dhe pa limit. <i>(Evidenca 2.28 – Të dhëna për infrastrukturën; Evidenca 2.25 – Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 4.10 – Të dhëna për burimet e literaturës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën; Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019; Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17; Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës)</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentët kanë mundësi aksesit të barabartë dhe në burime online. Me nje fond rreth 85000 libra dhe 12 milion artikuj shkencore, të tilla si: COBISS.AL; Publications/UNRISD; Cultivate your knoëledge; Openedition Journals; EuroPS-Services që janë open source dhe pa limit. COBISS+ mund të aksesohet përmes e-mail zyrtar dhe po ashtu RASH ofron dhe manulain e përdorimit. <i>(Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17; Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë	Studentët kanë mundësi aksesit në katalogun e rekordeve online si pjesë e paltformës COBISS me nje fond rreth 85000 libra dhe 12 milion artikuj shkencore. COBISS+ mund të aksesohet nga studentët e programit BA në APS nga kudo përmes e-mail zyrtar dhe po ashtu RASH ofron dhe manualin e përdorimit.

shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	(Evidenca 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17; Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën)
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	FSHS u vë në dispozicion studentëve të Programit të studimit BA në APS për garantimin e njohurive me literaturë përdorimin e bibliotekës e cila funksionon për të gjithë studentët nga ora 08.00-18.00. (Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019)
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	FSHS ka një procedurë lidhur me përditësimin e literaturës përmes botimeve të fundit. Propozimet e njësisë bazë miratoren sipas procedurave të UT. Pasurimi i fondit të bibliotekës ka një zë të vecantë në buxhetin vjetor të UT. Gjithashtu, fondi i bibliotekës pasurohet dhe përmes donacioneve: si Fondacioni Soros, UNICEF, Ambasada Franceze. (Evidenca 2.25 – Të dhëna për bibliotekën; Evidenca 4.10 – Të dhëna për burimet e literaturës; Evidenca 2.26 – Buxheti për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 2.27 – Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën)
Konkluzione	GVJ konstaton se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht, pasi FHS ka siguruar një bibliotekë dhe një sistem online që përmbush realizimin e procesit mësimdhënës/mësimnxënës të programit të studimit Bachelor në APS. Gjithashtu, GVJ sugjeron që në literaturën e detyrueshme të moduleve/lëndëve përvec teksteve në gjuhën angleze të punohet për të përfshirë tekste mësimore të botuara në gjuhën shqipe.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se FSHS në përputhje me LAL 80/2015 si dhe aktet e rregullative të saj administron përmes sekretarisë mësimore regjistrat e të dhënave të studentëve (themeltar, arritjeve akademike dhe lëshimit të diplomave). Sekretaria i ruan të dhënat në mënyrë elektronike dhe hard copy. Në UT/FSHS funksionon Sektori i IT-së dhe Sistemi kompjuterik, i cili është një sistem modular që operon mbi bazën e moduleve të ndryshme. Përdorimi i sistemit është i rregulluar me anë të një manuali. Përmes sistemit, studentët mund të regjistrojnë orarin, lëndët semestrale, tërheqin vërtetime notash, si dhe shërbime të tjera. <i>(Evidenca 2.9 – Rregullore e sekretarisë mësimore)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli akademik dhe studentët kanë akses në informacione në përputhje me Ligjin e ruajtjes së të dhënave dhe privatësisë sipas Rregullores së UT. Sistemi i menaxhimit të të dhënave nga studentët dhe stafi akademik është një sistem i dedikuar nga AKSH, e-albania ku përmes aksesit përmes IT mundësohen dokumentacione në shërbim të pedagogëve (informacione mbi lëndët, studentëve të regjistruar në sezona, procesverbale) dhe studentëve (informacion për statusin, lëndëve që frekuentojnë dhe rezultateve akademike).. GVJ konstatoi se aktiviteti dhe dokumentacioni i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ administrohet përmes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ku administrohen dhe përditësohen regjistrat, dosjet e personelit dhe librezat e punonjësve. Gjithashtu, bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, DPPS ruan dokumentacionin lidhur me personelin sa i takon ngarkesës, raporteve të realizimit të ngarkesës dhe programet lëndore të programit të studimit.

	(Evidenca 1.8 – Rregullore UT për mbrotjen përpunimin e të dhënave https://unitir.edu.al/aksesi-online/ https://digjitale.sociale.al/; Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ konstatoi se UST garanton dhe forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit pedagog-student duke përdorur dhe platforma si Microsoft Teams duke mundësuar komunikim nëpërmjet rubrikave të platformës. Gjithashtu, përmes platformë sociale.al janë zhvilluar sesione online me ndërveprimin e studentëve. https://digjitale.sociale.al/
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	FSHS disponon platformat elektronike si e-student përmes e-albania, Microsft Team, të cilat garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësojnë raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Gjithashtu, DPPS ruan dokumentacionin lidhur me personelin sa i takon ngarkesës, raporteve të realizimit të ngarkesës dhe programet lëndore të programit të studimit. (Evidenca 1.10. Manual perdorimi i sistemit informatik e-student 2022)
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se FSHS ka faqen ëeb përmban informacon në gjuhë shqip dhe anglisht. Gjithashtu, bazuar në Statutin e UT, njësia bazë DPPS duhet të publikojë informacione që lidhen me programin e studimit (rregullore, plani mësimor, struktura mësimore, personeli akademik, kalendari i provimeve etj). GVJ, sugjeron se hapësira e këtij programi studimi në faqen web duhet të pasurohet me më shumë të dhëna për studenët sa i takon informacioneve për këtë program. https://fshs-ut.edu.al/ https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pune-dhe-politika-sociale/bachelor-administrim-dhe-politike-sociale
Konkluzione	GVJ vlerëson se FSHS disponon një sistem të mirë të brendshëm të menaxhimit institucional të informacionit për




	veprimtarinë akademike dhe administrative në përmbushje të misionit të programit të studimit. GVJ, sugjeron se hapësira e këtij programi studimi në faqen ëeb duhet të mundësohet dhe në gjuhë të huaj si dhe të pasurohet me më shumë të dhëna për studentët sa i takon informacioneve për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	FSHS harton raportin me mbështetjen financiare sipas nevojave për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Projekt buxheti hartohet nga administratori mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore dhe bazë mbështetur dhe në planin strategjik të zhvillimit të UT, planin buxhetor afatmesëm (3 vjeçar) dhe më pas miratohet nga BA me propozim të Senatit akademik. Pas miratimit buxheti kalon për menaxhim nga Drejtoria e Financës dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësisë për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit të studimit; shpenzimet operative për mirëmbajtjen dhe facilitimin teknologjik të procesit mësimor; pasurimin e fondit të bibliotekës, projektet, grantet etj. (Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, për FSHS; Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023; Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS)
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet	Raporti financiar përmban të gjitha zërat financiarë, si: pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen dhe facilitimin teknologjik të procesit mësimor; pasurimin e fondit të bibliotekës, projektet, grantet ku FSHS dhe stafi i përfshirë janë partnerë etj.




operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	(Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS; Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023; Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UT dhe FSHS si pjesë përbërëse e dokumenton gjendjen e financimit dhe aktivitetin e tij financiar, përmes Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit hartohet dhe paraqitet Raporti Financiar Vjetor. UT dhe FSHS, në mënyrë periodike është subjekt i auditit të brendshëm nga Drejtoria e Auditit Financiar të UT si dhe subjekt i auditit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MAS. (Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS; Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023; Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS)
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	FSHS raporton për realizimin e buxhetit të miratuar për vitin paraardhës në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. Raporti vjetor delegohet për informim te drejtuesit e njësive kryesore. (Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS; Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023; Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS)
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të	UT dhe FSHS garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit pasi burimet e financimit si institucion publik garantojnë një pjesë nga buxheti i shtetit dhe një pjesë nga të ardhurat e siguruara nga tarifat e regjistrimit/studimit dhe të ardhura nga shërbime të tjera të ofruara nga institucioni. Gjithashtu, UT shqyrton përmes

mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	analizës financiare mirëmenaxhimin e fondeve në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së tij financiare. (Evidenca 2.30. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS; Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023; Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS)			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme dhe të qëndrueshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Punë Sociale. FSHS raporton për realizimin e buxhetit të miratuar për vitin paraardhës në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. FSHS, në mënyrë periodike është subjekt i auditit të brendshëm nga Drejtoria e Auditit Financiar të UT si dhe subjekt i auditit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve	UT zbaton politika dhe ka procedura që mbulojnë aktivitetin akademik të studentëve të programit BA në APS në përputhje me LAL 80/2015 dhe akteve të brendshme rregullative. Procedura e pranimin është në përputhshmëri me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e MAS. Kriteret dhe porcedurat

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	e pranimi parashikohen në Statut, Rregulloren e Universitetit, Kuotat e propozuara dhe miratuara të pranimi të studentëve dhe kriterëve të propozuara nga DPPS sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret e pranimi, tarifat e regjistrimit për programin BA në Administrim dhe Punë Sociale mund të aksesohen dhe në faqen web të UT. <i>(Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; Evidenca 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimi 2023-2024; Evidenca 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimi 2021-2024)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UT garanton procedurat e pranimi sa i takon të drejtave dhe detyrimeve, të përcaktuara në Statut, Rreguloren e Universitetit, Rreguloren e Fakultetit të Shkencave Politike, Rreguloren e Programit të Studimit BA në Administrim dhe Punë Sociale, barazinë dhe të drejtat e studentëve që nga momenti pranimi dhe regjistrimit e deri në përfundimin e ciklit të parë të studimit që përmbyllet me diplomimin. <i>(Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; Evidenca 3.13.; Vendimi për miratimin e kuotave të pranimi 2023-2024; Evidenca 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimi 2021-2024)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe	UT harton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në programet e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve propozohen nga DPPS në përgjigje të kërkesës së MAS, bazuar në kuotat e pranimeve një vit para fillimit të vitit akademik. Propozimet miratohen me vendim SA. Kuotat e pranimi për përogramin Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale parashikojnë dhe regjistrimin e studentëve të huaj nëse kanë të mbrojtur gjuhën shqipe. Nuk ka patur deri më tani të regjistruar studentë të huaj, por ka patur studentë nga trojet shqipfolëse. <i>(Evidenca 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimi 2023-2024; Evidenca 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimi 2023-2024)</i>




regjistrimin e studentëve të huaj.	
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të parashikuara në Rregulloret e institucionit (Rregullorja e UT, FSHS, DPPS). Informacionet janë të aksesueshme në faqen web https://unitri.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/ https://fshs-ut.edu.al/njoftimet-e-fundit/ <i>(Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS)</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UT përpara fillimit të vitit akademik informon kandidatët potencialë përmes faqes web / rrjeteve sociale/ fletëve informuese dhe komunikimit të drejtpërdrejtë lidhur me kuotat, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si dhe procedurat e pranimit të tyre në programin e studimit. Gjithashtu përdoren dhe javët orientuese. https://unitri.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/ https://fshs-ut.edu.al/studentet/broshura-per-maturantet/
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	FSHS para fillimit të çdo viti akademik parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtresat e marginalizuara. Ato janë të aksesueshme online ose përmes komunikimit të drejtpërdrejtë. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1745 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1669 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1392
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kuotat e pranimit për përogramin Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale parashikojnë dhe regjistrimin e studentëve të huaj nëse kanë të mbrojtur gjuhën shqipe. Nuk ka patur deri më tani të regjistruar studentë të huaj, por ka patur studentë nga trojet shqipfolëse.




	(Evidenca 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit 2023-2024; Evidenca 3.14. Vendimi për miratimin e kritereve të pranimit 2023-2024)			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UT ka procedura përkatëse për të implementuar bursa sociale për shtresat në nevojë dhe bursa ekselence për të rritur cilësinë e programeve të studimit. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1042 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1077 (Evidenca 3.23. Vendim Nr 7 2022 Miratimi i listave emërore shitesë të studentëve përfitues burse; Evidenca (shitesë) 20.1. Lista përmbledhese e studenteve që përfitojnë burse gjate 5 viteve te fundit; Evidenca (shitesë) 20.2 Lista dhe lloji i bursave te dhene ne kete program studimi)			
Konkluzione	GVJ konstaton se UT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të barabarta dhe transparente për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UT ofron informacion të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Numri i krediteve të domosdoshme për kalimin nga një vit te tjetri si dhe humbja dhe përsëritja e vitit për shkak të mos plotësimit të saj, prashikohet ne Rregulloren e FSHS; DPPS dhe Programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale. Studentët informohen nga pedagogët në cdo fillim viti akademik lidhur me syllabusin dhe detyrimet lëndore, sistemin e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të studentëve.

	<i>(Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	FSHS UT ka të parashikuar në mënyrë të detajuar procedurat e njohjes nga kualifikimet e mëparshme në një sërë aktesh (Statut, Rregullore e UT, Rregullore e FSHS dhe Rreguloren e Programit të studimit BA ne Administrim dhe Politikë Sociale). Infoamcioni është i aksesueshëm pranë sekretarisë mësimore të FSHS por dhe në faqen web të institucionit <i>(Evidenca 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale; Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1423; https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1166)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët informohen nga pedagogët në cdo fillim viti akademik, por dhe gjatë vitit, lidhur me syllabusin dhe detyrimet lëndore, sistemin e vlerësimit, format e kontrollit dhe vlerësimit të studentëve. <i>(Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; Evidenca 4.3. Programet e lendeve)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët e programit të studimit BA ne Administrim dhe Politikë Sociale diplomohen me punim diplome ose provim të përgjithshëm formimi. DPPS ka të parashikuar në rreguloren e programit procedurat e diplomimit si dhe pëmes paketës udhëzuese për punimin e diplomës. Studentët me mesatare mbi 9 kanë të drejtë të mbrojnë diplomën me një temë. Departamenti kujdeset që të përgatisin edhe bankën e pyetjeve në rastet e provimit të përgjithshëm. <i>(Evidenca 3.6. Rregullore e Programit BA APS; Evidenca 4.5. Paketa e punimit te diplomes; Evidenca 2.11. Rregullore e diplomimit; Evidenca (shtese). 15. Model provimi final dhe model teze provim formimi.)</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të	Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit dhe publikon udhëzues të posacëm për informimin e studentëve potencialë për t'i informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Gjithashtu FSHS

posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	është aktiv në rrjetet sociale dhe faqen web lidhur me programet e studimit të ofruara prej tij. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1310 https://fshs-ut.edu.al/studentet/broshura-per-maturantet https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pune-dhe-politika-sociale/bachelor-administrim-dhe-politike-sociale			
Konkluzione	GVJ konstaton se FSHS, UT ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale, informacionin e nevojshëm mbi vlerësimin e dijeve, njohjen dhe transferimin e krediteve deri në përfundim të ciklit të studimeve dhe diplomimit të studentëve. Studentët kanë të drejtë të mbyllin programin e tyre të studimit me sukses nëpërmjet provimit final ose një teme diplome (mesatare mbi 9).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimeve në institucion, rezultoi se informimi i studentëve fillon që në takimet informuese që zhvillon DPPS me studentët e vitit të parë të saporegjistruar lidhur me informimin mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, ndarjen në semestra, planit mësimor, krediteve të fituara, objektivat e programit, shfrytëzimit të bibliotekës, auditoreve si dhe Rregulores së programit të studimit. Informacione mbi programin e studimit janë të aksesueshme dhe në faqen web. https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pune-dhe-politika-sociale/bachelor-administrim-dhe-politike-sociale
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	




Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	FSHS UT ka politika orientuese për studentët në lidhje me tregun e punës. UT mer pjesë rregullisht në Panairin e Punës. Zyra e Aluminit dhe Karrierës u shërben studentëve për krijimin e kontakteve dhe orientimit me tregun e punës. Përqindja e punësimit tregon se të diplomuarit në BA APS kanë një përqindje punësimi të lartë mbi 50% që në dy vitet e para të diplomimit. Për vitin 2021-2024 57% janë të punësuar. <i>Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë</i> <i>Evidenca (shtese) 26.2. Te dhena per punesimin e studenteve ne vite</i> https://fshs-ut.edu.al/njoftime/karriera https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1482
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve të programit BA në APS u vihet në dispozicion informacioni lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e njësive kryesore, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e institucionit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. https://estudent.unitir.edu.al/e_student_ut https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pune-dhe-politika-sociale/bachelor-administrim-dhe-politike-sociale
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	I gjithë informacioni lidhur me programin e studimit është i aksesueshëm si në faqen zyrtare të internetit, ashtu edhe në platformën e-student. Studentët kanë akses në këto burime përmes kredencialeve të tyre personale, të lëshuara nga institucioni, të cilat përfshijnë një adresë elektronike me domain të zyrtarizuar (p.sh. emri.mbiemri@universiteti.edu). https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pune-dhe-politika-sociale/bachelor-administrim-dhe-politike-sociale
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se informacioni i vënë në dispozicion për studentët është i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm lidhur me objektivat, strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e FSHS mban statistika vjetore mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit Bachelor ne Adiministrim dhe Politikë Sociale të pasqyruara në regjistri themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore. Nr i studentëve të regjistruar sipas viteve: <table border="1"> <tr> <td>V.A. 2020-2021</td><td>101 studentë</td></tr> <tr> <td>V.A. 2021-2022</td><td>100 studente</td></tr> <tr> <td>V.A. 2022-2023</td><td>96 studentë</td></tr> <tr> <td>V.A. 2023-2024</td><td>71 studentë</td></tr> <tr> <td>V.A. 2024-2025</td><td>73 studentë</td></tr> </table> (Evidenca (shitese) 25. Tabele me nr e studentevete regjistruar, crregistruar dhe transferimet)	V.A. 2020-2021	101 studentë	V.A. 2021-2022	100 studente	V.A. 2022-2023	96 studentë	V.A. 2023-2024	71 studentë	V.A. 2024-2025	73 studentë
V.A. 2020-2021	101 studentë										
V.A. 2021-2022	100 studente										
V.A. 2022-2023	96 studentë										
V.A. 2023-2024	71 studentë										
V.A. 2024-2025	73 studentë										
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore e FSHS mban statistika vjetore në mënyrë elektronike dhe fizike mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit Bachelor ne Adiministrim dhe Politikë Sociale. Në këtë program nuk ka patur c'registrime dhe transferime nga programe të tjera. (Evidenca (shitese) 25. Tabele me nr e studentevete regjistruar, crregistruar dhe transferimet; Evidenca 4.8 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve)										
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve	GVJ konstaton se sekretaria mësimore e fakultetit menaxhon të dhënat manualisht dhe në mënyrë elektronike si dhe										

duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	nëpërmjet sistemin e-student. Ruajtja e tyre garantohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe mund të jenë të aksesueshme nga personat e autorizuar. (Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarise Mesimore; Evidenca 1.8 Rregullore UT "Per perpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e te dhenave personale")
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Gjatë vizitës në sekretarinë mesimore u konstatua se zotërohen dhe ruhen në mënyrë rigoroze të dhënat. Ato u shqyrtuan gjatë këtij procesi vlerësimi. Fakulteti i FSHS, UT dhe departamenti DPPS raporton realizimin e objektivave dhe veprimtarisë mesimore-kërkimore për cdo vit akademik. Sekretaria mesimore dhe institucioni raporton këto të dhënë edhe në raportin vjetor, që UST i dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përfshihet numri i përditësuar i studentëve të diplomuar. Regjistrat plotësohen në formë të shkruar dhe format elektronik duke ruajtur të dhënat në zbatim të udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi. (Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarise Mesimore; Evidenca 18.1. dhe 22.1. Raporti vjetor i DPPS 2021 2022; Evidenca 18.2. dhe 22.2. Raporti vjetor i DPPS 2022 2023; Evidenca 18.3. dhe 22.3. Raporti vjetor DPPS 2023-2024)
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, DPPS ka hartuar raporte analitike periodike lidhur me plotësimin e objektivave mesimore dhe kërkimore, ecuria e programeve të studimit, cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve, si dhe me objektivat për vitet pasuese akademike (si psh: nënshkrimi marrëveshjeve në fuksion të praktikës, organizimi ëorkshopeve për studentët, realizimi i projekteve etj.). Gjithashtu, Departamenti bashkëpunon dhe Zyrën e Alumnit lidhur me përditësimin e të dhënave statistikore të punsimit të studentëve që ndjekin programin BA ne APS. (Evidenca 2.16. Analize vjetore e punes FSHS; Evidenca 3.18. Raporti i veprimtarise se DPPS 2021-2024; Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë; Evidenca (shtese) 18.1. dhe 22.1. Raporti vjetor i DPPS 2021 2022; Evidenca (shtese) 18.2. dhe 22.2. Raporti vjetor i DPPS 2022 2023; Evidenca (shtese) 18.3. dhe 22.3. Raporti vjetor DPPS 2023-2024)

Konkluzione	GVJ konstaton se FSHS, UT, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhënat në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale. GVJ konstatoi se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, DPPS ka hartuar raporte analitike periodike lidhur me plotësimin e objektivave mësimore dhe kërkimore, ecuria e programeve të studimit, cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe me objektivat për vitet pasuese akademike			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në FSHS, UT studentët përfshihen dhe angazhohen me përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale dhe vendimmarrëse të IAL, si: Senati Akademik dhe në komisionet e tij si Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprmtarisë dhe Marëdhënies me Studentë dhe Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë. Gjithashtu, studentët janë të organizuar në përputhje me LAL dhe në Këshillin studentor për secilin Fakultet.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit akademik në mënyra të ndryshme. Studentët përfshihen dhe në vlerësimin e procesit akademik përsëritet për zhvillimin e pyetësorëve. Çdo komision përfshin një përfaqësues studentor. Për më tepër, studentët marrin pjesë në vlerësimin e stafit akademik përmes pyetësorëve të posaçëm për këtë qëllim. Këshili studentor FSHS, UT janë organe kolegjiale me përfaqësues të zgjedhur nga vetë studentët. Studentët janë aktorë të vlerësimit të lëndëve dhe pedagogut përmes anketimeve periodike të NJSBC. (Evidenca 2.4. Rregullore e FSHS; Evidenca (shtese) 23. Vendime Senati Akademik ku vertetohet pjesëmarrja e

	studentit; Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative; Evidenca 2.15. Te dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB; ; Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024; Evidenca 4.17 Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18.a. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022 – 2023; Evidenca 4.18.b. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2023-2024; Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative) https://unitir.edu.al/keshillat-e-studenteve/ https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1104 https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1006
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstaton se DPPS garanton përfshirjen e studentëve në procesin e marrjes së vendimeve, këshillimin ose vlerësimin e procesit akademik në përmirësimin e Kurikulës ku diskutohet në mënyrë periodike dhe me ren në konsideratë mendimet e studentëve lidhur me ndryshimet/përditësimin e Kurrikulës për Programin BA në APS. Gjithashtu, DPPS në bashkëpunim me NJSBC, përfshin studentët në proceset e hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm të programit në funksion të akreditimit, po ashtu dhe në hartimin, shpërndarjen dhe plotësimin e pyetësorëve për cilësinë e programeve të studimit dhe personelit akademik. (Evidenca 4.17 Feedback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.2.b. Ndryshimet në planet mesimore 2023-2024)
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	GVJ konstaton se FSHS, UT ka procedura të ankimimit lidhur me rezultatin e kontrollit të dijeve të cilat janë të përcaktuara në pëpruthje me ligjin në fuqi në aktet rregullative të IAL dhe njësisë kryesore FSHS. Studentët kanë të drejtën të paraqesin kërkesat e tyre zyrtarisht pranë strukturave të njësisë bazë, duke respektuar rregullat dhe afatet kohore të përcaktuara nga FSHS për këtë qëllim. (Evidenca 2.4. Rregullore e FSHS; Evidenca 3.6. Rregullore e programit të studimit; Evidenca 4.3. Programet mësimore; Evidenca (shtese) 15. Model provimi final dhe model teze

njesisë/pedagogut përgjegjës.	provim formimi; Evidenca 3.9. Format e kontrollit të njohurive.)			
Konkluzione	GVJ konstaton se FSHS, UT përfshin studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të përmirësimit të kurikulës dhe sigurimit të cilësisë për programin e studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale. Çdo komision përfshin një përfaqësues studentor. Studentët kanë të drejtën të paraqesin kërkesat e tyre zyrtarisht pranë strukturave të njësisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	FSHS, UT ka një disa struktura të posaçme për informimin dhe orientimin e studentëve lidhur me procesin mësimor, orientimin e studentëve të rinj, kurikulat, diplomën, dhe mundësitë e punësimit, info day, trajnime, takime të hapura, etj. Strukturat përgjegjëse për këtë janë Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studenë, Sekretaria mësimore, Sekretaria e departamentit, koordinatori i Programit të studimit, që në bashkëpunim me njëri tjetrin mbulojnë të gjithë kërkesat e studentëve. (Evidenca 2.5. Rregullore e Sekretarise mesimore; Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative; Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë) https://fshs-ut.edu.al/ https://fshs-ut.edu.al/studentet/orari-mesimor https://fshs-ut.edu.al/studentet/udhezime
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të	FSHS/DPPS ka krijuar dhe vënë në funksion një sistem të dedikuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistencën në çështje që lidhen me procesin

posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	mësimor dhe programin e studimit. Ata mund të drejtohen në strukturat më sipër për të gjetur zgjidhje për problematikat e tyre. Gjithashtu, në mjediset e FSHS janë instaluar ekrane elektronike, ku shfaqen në mënyrë të vazhdueshme informacione të rëndësishme mbi aktivitetet akademike dhe njoftime të tjera të fakultetit. <i>(Evidenca 2.5. Rregullore e Sekretarise mesimore; Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative; Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë; Evidenca 3.11 Vendim për koordinatorin e programit; Evidenca 3.12. Detyrat e koordinatorit)</i> https://fshs-ut.edu.al/ https://fshs-ut.edu.al/studentet/orari-mesimor https://fshs-ut.edu.al/studentet/udhezime https://e-student.unitir.edu.al/e_student_ut
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se ka një strukturë të posaçme Zyra e Alumnit dhe Karrierës e cila në bashkëpunim me DPPS ofron shërbime për studentët lidhur me zhvillimin e karrierës dhe Edukimit të Vazhduar me qëllim aftësimin e tyre profesional për të qenë proaktiv me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. Zyra e realizon këtë përmes takimeve për këshillimin e karrierës duke përfshirë: evente, takime, intervista me punëdhënës potencialë në nivel lokal dhe qendror. Zyra bashkëpunon me DPPS për orientimin e studentëve në kuadër të praktikave mësimore. Gjithashtu, koordinatori i departamentit si dhe stafi angazhuar për supervizimin e praktikave mësimore ofrojnë orientim për detyrat gjatë zhvillimit të praktikës që më pas mund të shërbejë si potencial punësimi për studentët. <i>(Evidenca 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë; Evidenca 3.11 Vendim për koordinatorin e programit; Evidenca 3.12. Detyrat e koordinatorit; Evidenca 3.17. Lista e marreveshjeve për praktikën mësimore; Evidenca (shitese) 11. Marreveshjet e bashkëpunimit me partneret për praktiken e studentëve; Evidenca (shitese) 12. Model i dosjes së praktikës profesionale)</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët	Zyra e Alumnit dhe Karrierës mbledh dhe përpunon të dhënat e studentëve lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit. Të




pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	dhënat e analizuar përcillen te drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për analiza të mëtejshme. (Evidenca 4.2.1. Analiza e tregut të punës; Evidenca 4.2.b. Të dhëna përmbledhëse për punësimin e studentëve; Evidenca (shkurt) 26.1. Formular për alumni)			
Konkluzione	GVJ konstaton se FSHS, UT ka krijuar procedura dhe zyra të posaçme me qëllim pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, dhe që janë lehtësisht të menaxhueshme dhe të prekshme nga studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstaton se FSHS, UT ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, të tillë si: udhëzuesi për mësimin në distancë për personelin; udhëzuesi për mësimin në distancë për studentët dhe udhëzuesi për vlerësimin në distancë. Gjithashtu, në nivel institucional UT ka në zbatim dhe Strategjinë Institucionale për mësimdhënien 2022-2027 dhe Planin strategjik për zhvillimin e personelit.

	(Evidenca 1.15. Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimit në distance; Evidenca 1.17. Vendim për disa shtesa në Udhëzuesin e UT-së "Për zhvillimin e mësimit në distancë"; Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional; Evidenca 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënie 2022-2027 vendim-nr.24.; Evidenca 1.25. Plan strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mesimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	FSHS, UT ka të ngritur një strukturë, Njësinë e Sigurisë së Brendshme të Cilësisë (NJSBC) e cila është ngritur me vendim SA dhe bazuar në Statutin dhe manualin e funksionimit kryen procesin periodik të vlerësimit të cilësisë së veprimtarive mësimore kërmikomore të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 (shtatë) anëtarë me përfaqësues nga secili departament FSHS, ku njëri anëtar prej tyre është përfaqësues staf akademik nga DPPS dhe një student. (Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 2.15. Te dhena për NJSC (tabela 24) dhe GVB)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mesimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	FSHS, UT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mesimdhënies, të vlerësimit të dijeve. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku njëri prej tyre është përfaqësues student. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë realizohet përmes përfshirjes në procesin e anketimit për cilësinë e mesimdhënies, pjesëmarrjes së përfaqësuesve në organet e larta vendimmarrëse, pjesëmarrjes në grupet e vlerësimit të brendshëm etj. Gjithashtu, ka procedurë të vecantë për ankime të studentëve, dhe menyrën e zgjidhjes së tyre. (Evidenca 2.13. rregullore NJSBC; Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC; Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; 1.11 Manuali i cilesise.pdf; 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë.pdf)
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie	GVJ konstaton se NJSBC bazuar në Rregulloren e njësive (mungon në listën e dokumenteve) dhe Përshkrimin e Veprimtarisë (mungon në listën e dokumenteve) duhet të përgatisë një Plan vjetor të punës me të gjitha veprimtaritë dhe

bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	detyrat konkrete si dhe instrumentet për matjen dhe sigurimin e cilësisë për programet e studimit. Gjithashtu NJSBC, duhet të hartojë dhe bëjë publike rezultatet e vlerësimit gjithëvjetor së bashku me rekomandimet përkatëse në kategorinë përkatëse (sigurimi cilësisë) në faqen ëeb të FSHS.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>GVJ rekomandon hartimin e një plan veprimi vjetor me detyra dhe instrumenta konkrete për NJSBC me instrumentat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, bëren publike në faqen web të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise) të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC dhe rekomandimet në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se FSHS disponon politika dhe procedura për garantimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe harton formularë të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Gjithsesi, GVJ rekomandon hartimin e një plan veprimi vjetor për NJSBC me instrumentat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, bëren publike në faqen ëeb të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC dhe rekomandimet në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Në FSHS ka strukturë të posaçme, Njesia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Gjithashtu ka procedura, manual për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është konceptuar dhe funksionon në përputhje me standardet dhe udhëzimet për sigurimin të Arsimit të Lartë sipas Ligjit nr. 80/2015, datë

aktet rregullatore institucionale.	22.07.2015, NJBSC ka vepruar si një njësi organizative e përhershme. NJSBC ka në përbërjen e saj 7 anëtarë ku 5 (pesë) anëtarë përfaqësojnë secilin departament; 1 (një) anëtar nga administrata dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues student. <i>(Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë; 1.11Manuali i cilesise.pdf; Evidenca 1.14.1. Vendim SA për dokumentat e sigurimit të cilësisë; Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UT në përbërje të strukturës së tij organizative ka të ngritur, dhe mban në funksion zyrën e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Sektori I Sigurimit të brendshëm të cilësisë është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. NJBSC ushtron aktivitetin e saj në zbatim të LAL 80/2015 dhe me aktivitetin e saj synon në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e cilësisë. UT dhe FSHS ka hartuar politika dhe strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë: Strategjia e zhvillimit UT 2018-2023, Paketa e Instrumentave të Cilësisë; Manuali i Cilësisë; Strategjia Institucionale për Mësimdhënien; Strategjia e Zhvillimit të FSHS etj. Funksionimi i NJSBC garantohet nga statuti i UT dhe Manuali i Cilësisë të hartuar në përputhje me Kodin e cilësisë për arsimin e lartë të gjithë periudhën e funksionimit të saj NJBSC përbëhet nga burimet e nevojshme njerëzore, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë të gjitha objektivat dhe funksionet e saj. Anëtarë të njësisë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë pjesëtarë me eksperiencë të personelit akademik nga fakultetet aktuale si edhe përfaqësues të administratës dhe të studentëve. Në këtë zyrë aktivizohen, përvec, stafit akademik edhe studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që FSHS, UT ka me institucione homologe dhe aktorë të tregut të punës si: nëpërmjet tryezave të rrumbullakta dhe aktivitete si programe trajnimi psh Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional apo dhe Qendrës për Drejtësi dhe Transfromim. <i>(Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 1.1. Manuali i cilesise; Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24; Evidenca 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 1.25. Plani strategjik i UT per zhvillimin e</i>

	<i>personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023; Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	FSHS, UT per sigurimin e cilësisë mbështetet në perpilimin e Raportit Periodik të Cikësisë. FSHS ka një paketë me instrumentat për sigurimin e cilësisë që përmban formularë, pyetësorë dhe raporte për njësinë kryesore, njësinë baze, pedagogët dhe studentët, duke u mbështetur në standardet dhe kriteret e legjislacionit per arsimin e lartë në Republikën e Shqiperisë. NJBSC ka si funksion kryesor garantimin e cilesisë, përmiresirnin e vazhdueshem të saj ne aaritjen e objektivave të përcaktuara. UT përgjatë viteve të zhvillimit të veprimtarisë së tij i është nështruar procesit të akreditimit institucional periodik. Të gjitha vetëvlerësimet e brendshme dhe vleresimet e jashtme në UT bëhen duke u mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, si edhe takime me palët e interesuara. Këto akreditime nëpërmjet Raporteve të Ekspertëve të Jashtëm të Cilësisë dhe vlerësimeve të tyre kanë kontribuar për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve mësimore të UT. FSHS ka miratuar me Vendim nr.43, 13.11.2024 dhe ngritjen e GVB për programin Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale me 5 (pese) antarë ku 1 (nje) është student. Ky program po i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit. <i>(Evidenca (shitese) 1. Vendimi nr 43, dt 13.11.2024 per krijimin e RVB-se; Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 1.1. Manuali i cilesise; Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024)</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për	FShS përmes NjsBC zhvillon në mënyrë të përvitshme aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues përmes pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e cdo programi studimi; kontrole për zbatimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të performancës së personelit të angazhuar në procesin e mësimdhënies, që shërben si një tregues i rëndësishëm ndihme për të ofruar një cilësi gjithnjë e në rritje në mësimdhënie nga ana e stafit akademik e ndihmës akademik. Përmes anketimit të studentëve në çdo fund semestri synohet marrja e mendimeve të tyre për zhvillimin e procesit mësimor dhe për performancën e pedagogut ndaj lëndës. Gjithashtu, vihet re një pjesmëarrje ulët e studentëve në

arritjet më të mira ne programin e studimit.	anketim 30% për vitin 2022-2023 dhe 44% për vitin 2023-2024. GVJ rekomandon angazhim të DPPS në bashkëpunim me NJSBC për rritjen e kuorumit pjesëmarrës të studentëve në anketimin e studentëve (Evidenca 4.12, Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit; Evidenca 4.17, Feesback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës; Evidenca 4.18a: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2022-2023 [semestri i dytë]; Evidenca 4.18b: Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në FShS në UT 2023-2024 (semestri i parë))			
Konkluzione	GVJ se FSHS dhe DPPS harton dhe zbaton politika e procedura transparente për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBC ka si funksion kryesor garantimin e cilesisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj në aritjen e objektivave të përcaktuara. GVJ rekomandon angazhimin e DPPS në bashkëpunim me NJSBC për rritjen e kuorumit pjesëmarrës të studentëve në anketimin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i	Gjithashtu, në mënyrë periodike janë zhvilluar pyetësorët e studentëve me fokus cilësinë e programeve të studimit dhe evdntimin e pikave të forta dhe të dobëta si dhe promovimin e praktikave të mira. GVJ konstaton se NJSBC bazuar në Rregulloren e njësive (mungon në listen e dokumenteve) dhe Përshkrimin e Veprimtarisë (mungon në listën e dokumenteve) duhet të përgatisë një Plan vjetor të punës me të gjitha veprimtaritë dhe detyrat konkrete si dhe instrumentet për

shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	matjen dhe sigurimin e cilësisë për programet e studimit. Gjithashtu NJSBC, duhet të hartojë dhe bëjë publike rezultatet e vlerësimit gjithëvjetor së bashku me rekomandimet përkatëse në kategorinë përkatëse (sigurimi cilësisë) në faqen ëeb të FSHS. <i>GVJ rekomandon hartimin e një plan veprimi vjetor me detyra dhe instrumenta konkrete për NJSBC me instrumentat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, bëren publike në faqen ëeb të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise) të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC dhe rekomandimet në funksion të transparencës për stuentët dhe publikun.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për pasqyrimin dhe përmirësimin e cilësisë. Për të vlerësuar cilësinë e programit, përveç analizës së pyetësoreve drejtuar studentëve FSHS ka hartuar dhe propozime për përmirësimin e kurikulës, si “Hartimi, ristrukturimi dhe përmirësimi i programeve të studimit” mbështetur nga Komisioni Përhershëm i Kurikulave, Komisioni i Përhershëm i Cilësisë dhe NJSBC me qëllim sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. <i>(Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 4.17, Feeback-u i studentëve për përmirësimin e kurrikulës)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	FShS përmes DPPS dhe NJSBC zhvillon në mënyrë të përvitshme kontrole për zbatimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të performancës së stafit të angazhuar në procesin e mësimdhënies, që shërben si një tregues irëndësishëm ndihme për të ofruar një cilësi gjithnjë e në rritje në mësimdhënie nga ana e stafit akademik e ndihmës akademik. Për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit, DPPS si njësi përgjegjësie për ofrimin e programit të studimit APS, përdor procese: - Raportimit narrativ të stafit pranë departamentit; - Përcaktimit të procedurës për rishikimin e kurrikulës; - organizimin e focus grupeve me studentë për përthithjen e mendimeve të tyre për lëndën;

testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	- përcjellja në auditor e mes pedagogëv e njohurive të reja që ata marrin përmes punimeve të reja shkencore apo e pjesëmarrjes në projekte; - raportimet mujore nga drejtuesi DPPS për ecurinë e programit tëstudimit - vlerësimi dhe miratimi i tezave të provimit nda drejtuesi I njësisë bazë (Evidenca (shtese) 9. Procesverbal i mbledhjes se DPPS; Evidenca (shtese) 15. Model provimi final dhe model teze provim formimi; Evidenca 18.1. dhe 22.1. Raporti vjetor i DPPS 2021 2022; Evidenca 18.2. dhe 22.2. Raporti vjetor i DPPS 2022 2023; Evidenca 18.3. dhe 22.3. Raporti vjetor DPPS 2023-2024; Evidenca 3.18. Raporti i veprimtarise se DPPS 2021-2024; Evidenca 3.15 Procedura për rishikimin e kurrikulës)
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	DPPS/FSHS në bashkëpunim me NJSBC dhe Zyrën e Karrierës përdor metoda të tërthorta si: - vlerësimi si studimin e tregut për të kuptuar trendet ritmike të profesionistëve të punës sociale; - pyetësorëve dhe intervistave me studentët e diplomuar alumni; - organizimi i takimeve me organizatat profesionale; - focus grupet me studentët për ecurinë e programit dhe përmirësimit të kurrikulës etj. DPPS bazuar në gjetjen dhe përpunimin e të dhënave lidhur me cilësinë ka përgatitur dhe Strategjinë e zhvillimit të programit të studimit BA në APS. (Evidenca 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022; Evidenca 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit Administrim dhe Politikë Sociale; Evidenca 4.14.a. Analiza e tregut të punës; Evidenca 4.14.b. Të dhëna për punësimin e studentëve; Evidenca 4.18.a.b. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022 – 2023; 2023-2024; Evidence 26.1. Formular per alumni)
Konkluzione	FSHS monitoron periodikisht cilësinë dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. Institucioni përdor metoda

	të ndrsyhme të drejtpërdrejta dhe tërthorta por GVJ rekomandon hartimin e një plan veprimi vjetor me detyra dhe instrumenta konkrete për NJSBC me instrumentat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në bazë të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” në UT, procesi i sigurimit të njësisë funksionon në nivel universiteti, përmes NJSBC, UT e cila garanton zbatimin e politikave të cilësisë dhe në nivel fakulteti NJSBC, FSHS që ka për objekt punë monitorimin e procesit të metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe monitorimin e zbatimit të standardeve të cilësisë, në përputhje me planin strategjik dhe misionin e njësisë kryesore. NJSBC në FShS, në nivel njësie kryesore është krijuar me Urdhër të Brendshëm të Dekanit nr. 14/2, dt. 15.07.2021. NJSBC është një strukturë e përhershme ndihmësakademike me karakter administrativ, që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. Kjo njësi, bashkëpunon me departamentet, si njësi përgjegjëse për ofrimin e programeve të studimit, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, e cila reflektohet edhe në raporte e kontrollit periodik. Njëkohësisht, me Urdhër të Dekanit nr. 3, dt. 12.05.2022 është ngritur Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme (KSCB) në FShS. Senati Akademik i UT-së me Vendim dt. 23.12.2020 ka miratuar Paketën e Instrumentave të Cilësisë ku përfshihen pyetësorë të ndryshëm për anketim të studentëve për vlerësimin e lëndës, për metodat e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies, etj. UT ka hartuar politika dhe një strategji institucionale 2022-2027 për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë zyrë aktivizohen, përveç, stafit akademik edhe studentët si dhe konsultohen dhe bashkëpunorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që FSHS/UT ka me institucione homologe dhe

	aktorë të tregut të punës. GVJ konstaton se DPPS si njësi bazë përgjegjës për programin ka ndërmarrë dhe studime të mirëfillta si: - Strategjia e Zhvillimit të DPPD 2021-2024; - Analizë e tregut të punës për profesionistët e punës sociale dhe adminsitrimin të shërbimeve sociale në Shqipëri“ për vitin 2024. <i>(Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 1.1. Manuali i cilesise; Evidenca 1.24. Strategjia institucionale per mesimdhenien 2022-2027 vendim-nr.24; Evidenca 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028; Evidenca 1.25. Plani strategjik i UT per zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023; Evidenca 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit Administrim dhe Politikë Sociale; Evidenca 4.14.a. Analiza e tregut të punës)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	UT/FSHS ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra specifike për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit. NjSBC në FShS, në nivel njësie kryesore është krijuar me Urdhër të Brendshëm të Dekanit nr. 14/2, dt. 15.07.2021. NjSBC është një strukturë e përhershme ndihmësakademike me karakter administrativ, që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore. Në këtë zyrë aktivizohen, përveç, stafit akademik edhe studentët dhe bashkëpunetorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që FSHS, UT ka me institucione homologe dhe aktorë të tregut të punës si: nëpërmjet tryezave të rrumbullakta dhe aktivitete si programe trajnimi psh Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional apo dhe Qendrës për Drejtësi dhe Transformim. <i>(Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 1.14.1. Vendim SA për dokumentat e sigurimit të cilësisë; Evidenca 1.11, Manuali i Cilësisë; ; Evidenca 1.14, Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 1.20. Vendim SA per ngritjen e qendrës virtuale te trajnimit dhe zhvillimit profesional; Evidenca 2.15. Te dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së	Ashtu sic përmendëm më lart, UT mundëson angazhimin e të gjithë aktorëve të brendshëm, staf akademik, ndihmës

programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	akademik dhe studentë, ku departamenti dhe fakulteti kanë një rol të madh, në garantimin e cilësisë për këtë program studimi. Një tjetër tregues i përfshirjes aktive të studentëve është pyetësi i organizuar nga NJVSBC në fund të çdo semestri, i cili shërben për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies për secilën lëndë. <i>Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca (shkurtë) 1. Vendimi nr 43, dt 13.11.2024 për krijimin e RVB-se; Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 4.18.a.b. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022 – 2023; 2023-2024)</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të cilësisë në FSHS, UT respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Koordinimi i procesit të vlerësimit të brendshëm bëhet nga përgjegjësi e Drejtuesit të departamentit DPPS dhe NJSBC. Personeli akademik i përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit nuk kanë pozicione drejtuese dhe janë anëtarë të personelit akademik dhe përfshirja e përfaqësimit të studentëve nga cikli II respekton integritetin dhe barazinë ndaj stafit dhe studentëve. <i>(Evidenca (shkurtë) 1. Vendimi nr 43, dt 13.11.2024 për krijimin e RVB-se)</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për sa i takon sigurimit të cilësisë, përveç, stafit akademik edhe studentët, DPPS ka patur dhe bashkëpunëtorë të jashtëm bazuar në marrëveshjet të bashkëpunimit që FSHS dhe DPPS ka me institucione publike si: - Shërbimi Social Shtetëror, - Inspektoriati i shërbimeve sociale, D - rejtoria rajonale të shërbimit social, Bashkia Tiranë, - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; - me organizata të Shoqërisë Civile si: Save the Children, UNICEF, Këshilli i Europës, AADF, Kryqi Kuq Shqiptar, Përtej Barrierve; Nëpërmjet tryezave të rumbullakta dhe aktivitete si programe trajnimi psh Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional apo dhe Qendrës për Drejtësi dhe Transformim, FSHS arrin të vjelë

	mendimet e aktorëve të jashtëm në lidhje me këtë program studimi. <i>(Evidenca 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional; Evidenca 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkepunimit dhe e partnereve për praktikën profesionale; Evidenca 3.19. Raport i fundit periodik analitik i përfitimit nga marrëveshjet; Evidenca 4.9. Tabela përmbledhëse për trajnime profesionale; Evidenca 4.12 Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit.)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se FSHS dhe DPPS ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se NJSBC, në përputhje me Rregulloren e njësisë dhe Përshkrimin e Veprimtarisë — dokumente të cilat aktualisht nuk figurojnë në listën zyrtare — duhet të hartojë një plan pune vjetor që përmban veprimtaritë e planifikuara, detyrat konkrete dhe instrumentet për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Po ashtu, njësia ka detyrimin të përgatisë dhe të publikojë raportin e analizës së vlerësimit vjetor, së bashku me rekomandimet përkatëse, në seksionin e posaçëm për sigurimin e cilësisë në faqen zyrtare të FSHS. <i>Gjithashtu, GVJ rekomandon bërjen publike në faqen eeb të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise) të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC si dhe rekomandimet dhe planin e masave për përmirësimin e cilësisë në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i>

	https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Gjithashtu, NJSBC duhet të përgatisë dhe të publikojë raportin e analizës së vlerësimit vjetor, së bashku me rekomandimet përkatëse, në seksionin e dedikuar për sigurimin e cilësisë në faqen zyrtare të FSHS. Publikimi i këtyre materialeve duhet të bëhet duke respektuar parimet e transparencës dhe njëkohësisht të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave sensitive, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat institucionale në fuqi. <i>Gjithashtu, <u>GVJ rekomandon</u> bërjen publike në faqen ëeb të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise) të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC si dhe rekomandimet dhe planin e masave për përmirësimin e cilësisë në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i> https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	NJSBC në procedurën e analizës së pyetësorëve ndjek miratimin e Raportit në Senat Akademik. Raportit i bashkangjiten rekomandimet të cilat i adresohen strukturave dhe më pas hartohet plani i masave për përmirësimin e cilësisë që miratohen në rektorat. <i>Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 2.15. Te dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB, 1. Vendimi nr 43, dt 13.11.2024 per krijimin e RVB-se; Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 4.18.a.b. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022 – 2023; 2023-2024</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Programet e studimit në FSHS, UT vlerësohen për qëllime të akreditimit të programit me ASCAL. Programi Bachelor në Administrim dhe Politikë Sociale është subjekt akreditimi për herë të parë. <i>Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 2.15. Te dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB, 1. Vendimi nr 43, dt 13.11.2024 per krijimin e RVB-se; Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë; Evidenca 4.18.a.b. Raporti i anketimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies 2022 – 2023; 2023-2024</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet nga përfshitja e tyre në

periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	strukturat e garantimit të cilësisë. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet, rregulloreve, studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (NJBSC, Senati Akademik, Këshilli studentor, Zyra e Karrierës dhe Alumni, Java e orientimit-që zhvillohet në fillim të vitit akademik). <i>(Evidenca (shtese) 23. Vendime Senati Akademik ku vertetohet pjesëmarrja e studentit; Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative; Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë; Evidenca 2.15. Te dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se UST zhvillon procese dhe veprimtari në tërësi efikase për krijimi dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu, GVJ rekomandon bërjen publike në faqen eeb të FSHS (Sigurimi i cilësisë https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise) të raportet vjetore sipas viteve të NJSBC si dhe rekomandimet dhe planin e masave për përmirësimin e cilësisë në funksion të transparencës për studentët dhe publikun.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në
"Administrim dhe Politikë Sociale"**

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi siguron mundësi bashkëpunimi me institucione, organizata dhe palë të treta duke kontribuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe mundësitë për punësim pas diplomimit;
2. Njësia përgjegjëse për programin e studimit siguron përmbushjen e kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë, duke ofruar një program të strukturuar, të organizuar dhe informues që garanton një proces të mirëfilltë të të nxëniet dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore me metodat dhe praktikatat më të mira;
3. Stafi akademik është me eksperiencë dhe i kualifikuar në fushat përkatëse në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe të vecanta të programit të studimit duke krijuar një mjedis mësimor të pasur dhe stimulues për studentët;
4. Institucioni ofron një qasje të integruar ndaj studentëve, duke siguruar mbështetje të plotë dhe asistencë në të gjitha aspektet e procesit mësimor dhe jetës studentore, dhe gjithashtu mundëson mundësi për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimeve shkencore;

b. Pika të dobta:

1. Përfshirja e ulët e stafit dhe mungesa e studentëve në projekte mobiliteti në programet Erasmus+ (*Standardi I.2, kriteri 2 dhe Standardi II.4, kriteri 4*);
2. Institucioni nuk ka zbatuar ndryshimet kërkuara nga VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe është e pajustifikuar në vonesën për implementimin e këtyre ndryshimeve. (*Standard II. 1, Kriteri 1, 2, 3*);
3. Departamenti nuk respekton kuadrin ligjor mbi mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik i brendshëm në masën 70%. (*Standard IV.1, Kriteri 2*);

Rekomandime

1. GVJ rekomandon mbulimin e ngarkesës mësimore nga stafi akademik i brendshëm në masën 70% duke respektuar kërkesat ligjore;
2. GVJ rekomandon marrjen e masave për finalizimin e punës për të realizuar ndryshimet kurikulare në zbatim të VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, me qëllim përshtatjen e programit të studimit më mirë me tregun e punës;
3. GVJ rekomandon për rritjen e bashkëpunimit dhe përfshirjen e stafit dhe studentëve në programet ndërkombëtare, kryesisht Erasmus+;
4. GVJ rekomandon që departamentet të shprehën në mënyrë eksplicite, me raport të veçantë për të gjitha ankimimet apo kërkesat e shprehur nga studentët, gjithnjë pasi janë diskutuar në mbledhjen e departamentit dhe të evidentohen zgjidhjet e mundshme që ju janë dhënë kërkesave të studentëve;



5. GVJ rekomandon një unifikim të rregulloreve për procese të vendimmarrjes, funksionimit të programit dhe regjistrimit të studentëve, pasi kanë mospërputhje mes tyre, në lidhje me numrin e sezoneve të mbrojtjes së diplomës, procesin e ankimimit të rezultatit përfundimtar të provimit, procesin e transferimit të studimeve dhe regjistrimet e studentëve në programe të dyta dhe procesin vendimmarrës për emërimin e koordinatorit dhe detyrve të tij;
6. GVJ rekomandon përditësime të literaturës sidomos për atë të detyrueshme në gjuhën shqip meqë kemi të bëjmë me studentë në ciklin Bachelor;
7. GVJ rekomandon që në mungesë të teksteve në gjuhën shqipe, leksionet e pedagogëve mund të botohen edhe si cikël leksionesh duke mbrojtur të drejtën e tyre të autorit dhe duke deklaruar burimin ku janë mbështetur për përgatitjen e këtyre leksioneve;
8. GVJ rekomandon përditësimin dhe unifikimin në një standard të formatit të syllabuseve të lëndëve/moduleve të programit të studimit, si dhe të kenë të shprehur në mënyrë të standardizuar politikat e frekuentimit mbështetur në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të programit të studimit APS;
9. GVJ rekomandon që stafi akademik e ndihmës akademik, kryesisht të brendshmit të përdorin adresa zyrtare për postën elektronike dhe jo private. Kjo gjë vërehet edhe në komunikimet mes anëtarëve të stafit administrative;
10. GVJ rekomandon që NjSBC të përgatisë raporte analitike për secilin departament më vete e më tej mund të realizojë analiza sasiore krahasuese mes tyre;
11. GVJ rekomandon përfshirjen në planin mësimor të një lëndë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke marrë në konsideratë zhvillimet e vazhdueshme të TI-së dhe përfshirjen e saj gjithnjë e më shumë në çdo fushë studimi e veprimi në përditshmërinë tonë;
12. GVJ rekomandon përmirësimin e informacionit në faqen web sa i takon sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes indikatorëve tregues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, raporteve periodike dhe vjetore në funksion të transparencës për palët e interesuara;



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in Administration and Social Policy provided by Faculty of Social Sciences, UT

a. Strengths and affirmations:

1. The program provides opportunities for cooperation with institutions, organizations and third parties, contributing to the professional development of students and employment opportunities after graduation;
2. The unit responsible for the study program ensures the fulfillment of legal requirements and quality standards, by offering a structured, organized and informative program that guarantees a proper learning process and the development of professional and scientific skills with the best methods and practices;
3. The academic staff is experienced and qualified in the relevant fields in accordance with the general and specific objectives of the study program, creating a rich and stimulating learning environment for students;
4. The institution offers an integrated approach to students, providing full support and assistance in all aspects of the learning process and student life, and also provides opportunities for the development of innovative ideas and scientific research;

b. Weaknesses:

1. Low involvement of staff and lack of student participation in mobility projects under Erasmus+ programs (*Standard I.2, criterion 2 and Standard II.4, criterion 4*);
2. The institution has not implemented the required changes from Decision of the Council of Ministers (DCM) no. 41, dated 24.01.2018, and the delay in implementing these changes is unjustified (*Standard II.1, Criteria 1, 2, 3*);
3. The department does not comply with the legal framework requiring that 70% of the teaching load be covered by internal academic staff (*Standard IV.1, Criterion 2*);

Recommendation

1. Ensuring that at least 70% of the teaching load is covered by internal academic staff, in compliance with legal requirements;
2. Taking measures to finalize the implementation of curricular changes pursuant to DCM no. 41, dated 24.01.2018, with the aim of better aligning the study program with the labor market;
3. Increasing cooperation and enhancing the involvement of staff and students in international programs, particularly Erasmus+;
4. Departments should explicitly report, through a separate document, all complaints or requests expressed by students, always after being discussed in departmental meetings, and clearly indicate the possible solutions provided;
5. A unification of regulations is needed concerning decision-making processes, program functioning, and student registration, since inconsistencies exist regarding: the number of thesis defense sessions, the appeal process for final exam results, the procedure for study



transfers and enrollment in second programs, and the decision-making process for the appointment of coordinators and their duties;

6. Updating of literature is needed, especially compulsory texts in the Albanian language, given that this concerns students at the Bachelor level;
7. In the absence of textbooks in Albanian, it is recommended that lecturers' lecture notes may be published as a lecture cycle, while protecting their copyright and citing the sources used in preparing the lectures;
8. Updating and unifying the format of course/module syllabys into a single standard, ensuring that attendance policies are expressed in a standardized manner in accordance with the regulations of the Faculty of Social Sciences and the APS study program;
9. It is recommended that academic and teaching support staff, particularly internal members, use official institutional email addresses rather than private ones. This issue is also evident in the communication among administrative staff members;
10. The Internal Quality Assurance Unit should prepare analytical reports for each department separately and subsequently conduct comparative quantitative analyses between them;
11. Including a course in the field of Information Technology in the curriculum, taking into account the continuous developments in IT and its increasing integration into all areas of study and daily practice;
12. Improving the information provided on the institution's website regarding internal quality assurance, by including direct and indirect performance indicators, as well as periodic and annual reports, in order to ensure transparency for stakeholders;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X